



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 13 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 04/2018 për Transparencë në Komuna, Udhëzimin Administrativ (MAPL) nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, neneve 14 dhe 15 parag.2.4, të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, si dhe në pajtim me nenin 35 shkronja o), dhe 37 pika 4 të Rregullores së Komunës së Podujevës për mënyrat, procedurat dhe kushtet e pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset e vendimmarrjes nr.01/18-02 të datës 31 janar 2011, në zbatim të Planit të Veprimit për Transparencë për periudhën 2019 – 2023 në Komunën e Podujevës, si dhe rekomandimit të Komitetit për Politikë dhe Financave nga mbledhja e mbajtur më 28 tetor 2019, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 30 tetor 2019, merr,

VENDIM PËR VËNIEN NË DISKUTIM PUBLIK

Neni 1

Vëhet në diskutim /debat publik, Draft Strategjia për Zhvillimin e Turizmit 2019-2021 në Komunën e Podujevës

Neni 2

Diskutimi publik sipas nenit 1, zgjat 30 ditë përkatësisht prej **31.10.2019 deri më 29.11.2019**, dhe debati publik me qytetarë mbahet më **15.11.2019** duke filluar nga **ora 11:00**, në objektin kryesor të Komunës - salla e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.

Neni 3

Propozimet, sugjerimet, apo vërejtjet eventuale paraqiten ditën e mbajtjes të debatit publik, gjithashtu në formë të shkruar mund të paraqiten gjatë kohëzgjatjes së diskutimit publik në Zyrën për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim, ndërtesa e Komunës zyra nr.32, si dhe në formë elektronike mund të dërgohen në e-mail adresat: nazmi.elezi@rks-gov.net dhe bujar.gimolli@rks-gov.net, të cilat pastaj i përcjellin në Drejtorinë përkatëse.

Neni 4

Dokumenti sipas nenit 1, është pjesë përbërëse e këtij vendimi dhe i njëjti publikohet në ueb-faqen zyrtare të Komunës: <http://kk.rks-gov.net/podujeve>

Neni 5


Diskutimi / debati publik zbatohet nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, në koordinim me Zyrën për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim, që përkujdesen për përgatitjen e raportit nga diskutimi / debati publik dhe të japin sqarime për arsyeshmërinë e pranimit ose mospranimit të propozimeve dhe sugjerimeve konkrete.

Neni 6

Vendimi hyn në fuqi pas publikimit ueb faqen zyrtare të Komunës.

Nr. 01-332/01-0084557/19
Podujevë, 30 tetor 2019





KOMUNA E PODUJEVËS

DRAFT - STRATEGJIA E ZHVILLIMIT TË

TURIZMIT

2019-2021

Hartues i Strategjisë: SPINP AGENCY

K. Podujeve & SPINP Agency

Ky draft dokument është hartuar në bazë të Kontratës Nr. 615-18-7546-2-2-1 e lidhur mes autoritetit kontraktues (Komuna e Podujevës) dhe ofruesit të shërbimeve (N.SH."Spinp Agency").

K. Podujeve & SPINP Agency

Përmbajtja e dokumentit

HYRJE	7
PROFILI I KOMUNËS SË PODUJEVËS	8
METODOLOGJIA E HARTIMIT TË STRATEGJISË	12
FAZA E PARË: VLERËSIMI I GJENDJES AKTUALE	12
FAZA E DYTË: KRIJIMI I PUNËTORIVE	12
VIZIONI.....	13
GJENDJA AKTUALE	14
TURIZMI DHE HOTELERIA.....	14
INFRASTRUKTURA RRUGORE	17
ARSIMI NË KOMUNËN E PODUJEVËS.....	17
RRJETI HEKURUDHOR	17
TRANSPORTI PUBLIK	18
TELEFONIA FIKSE.....	18
TELEFONIA MOBILE	18
MEDIAT LOKALE.....	18
INTERNETI	18
PYJET.....	18
TOKAT BUJQËSORE	19
BURIMET UJORE.....	19
BOTA BIMORE DHE SHTAZORE- LLOJET DHE PËRHAPIA E TYRE	20
TRASHËGIMIA KULTURO-HISTORIKE.....	23
AKTIVITETET KULTURORE NË KOMUNËN E PODUJEVËS.....	23
RESURSET UJORE	27
SWOT ANALIZA	33
OBJEKTIVAT	34
OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME	35
OBJEKTIVAT EKONOMIKE	35
OBJEKTIVAT ÇLËSORE	36
FUSHAT DHE DREJTIMET STRATEGJIKE	36
FUSHA KRYESORE: ZHVILLIMI I PRODUKTIT TURISTIK / BEGATIMI I OFERTËS TURISTIKE ...37	
FUSHA KRYESORE: PËRGATITJA DHE EDUKIMI I RESURSEVE NJERËZORE NË FUNKSION TË PËRMIRËSIMIT TË CILËSISË SË PRODUKTEVE DHE SHËRBIMEVE TURISTIKE	42
FUSHA KRYESORE: PROMOVIMI I PODUJEVËS SI DESTINACION TURISTIK GJATË TËRË VITIT	44
FUSHA KRYESORE: NGRITJA E INVESTIMEVE PUBLIKE, PRIVATE DHE PARTNERITETI PUBLIKO-PRIVAT	45

FUSHA KRYESORE: HARTIMI I POLITIKAVE DHE MENAXHIMI I TYRE NË SEKTORIN E TURIZMIT	47
ANEKSET	49
PLANI I VEPRIMIT 2019-2021	49
TABELA ME FSHATRAT E KOMUNËS SË PODUJEVËS GJITHSEJ 78 FSHATRA	53

K. Podujeve & SPINP Agency

Lista e shkurtesave:

DA	DREJTORIA PËR ADMINISTRATË
DBF	DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA
DKA	DREJTORIA PËR ARSIM
DSHMS	DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE
DPUMM	DREJTORIA PËR PLANIFIKIM URBAN DHE MBROJTJE TË MJEDISIT
DPKGJ	DREJTORIA PËR PRONË, KADASTËR DHE GJEODEZI
DKRS	DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT
DSHPMSH	DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE, MBROJTJE DHE SHPËTIM
DI	DREJTORIA PËR INSPEKSION
DBPZHR	DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL
DPZHE	DREJTORIA PËR PLANIFIKIM DHE ZHVILLIM EKONOMIK
MASHT	MINISTRIA E ARSIMIT SHKENCES DHE TEKNOLOGJISË
OE	OPERATORI EKONOMIK
SHC	SHOQËRIA CIVILE
MI	MINISTRIA E INOVACIONIT
MAPLH	MINISTRIA E AMBIENTIT DHE PLANIFIKIMIT HAPSINOR
ASK	AGJENSIONI STATISTIKAVE TË KOSOVËS
K.K.	KUVENDI KOMUNAL
PVLM	PLANI LOKAL I VEPRIMIT MJEDISOR
AMMK	AGJENSIONI PËR MBROJTJEN E MJEDISIT NË KOSOVË
AKP	AGJENSIONI I PYJEVE TË KOSOVËS
PLVM	PLANI LOKAL I VEPRIMIT NË MJEDIS
SHAB	SHOQATA E BJESHKATARËVE DHE ALPINISTËVE

HYRJE

Komuna e Podujevës si fokus të veçantë e ka zhvillimin ekonomik dhe po ashtu sektorin e turizmit si pjesë të saj. Pozita gjeografike, territori, resurset ujore, ekologjike, turistike, shëndetësore janë prioritet i DZHE-së. Në bazë të analizave që janë bërë në terren dhe potencialeve turistike që zotëron Podujeva, konstatohet se zhvillimi i sektorit të turizmit do të ndikojë pozitivisht në zhvillimin ekonomik lokal.

Duke u bazuar në prioritetet e Komunës së Podujevës por edhe rëndësinë që po i jepet kohëve të fundit turizmit, ky sektor konsiderohet me prioritet për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të Komunës së Podujevës. Podujeva ka resurse turistike në secilin nivel si atë: ekoturistik, rural, malor, shëndetësor, historik, fetar, ndërkufitar, etj.. Mangësitë e identifikuara në këtë aspekt kanë të bëjnë me informimin jo adekuat, cilësinë e shërbimeve, infrastrukturën, mbeturinat, etj.

Zhvillimi ekonomik i Podujevës mund të mbështetet në zhvillimin e turizmit dhe sektorëve tjerë që ndikojnë pozitivisht si transporti, komunikacioni, kurse ofertat dhe kostot janë të arsyeshme sidomos në sektorin e hotelierisë.

Dokumenti strategjik i DZHE-së për sektorin e turizmit kërkon koordinim nga të gjithë akterët si: niveli qendror, ekzekutivi komunal, bizneset dhe komuniteti i gjerë që të investojnë në zonat turistike e me këtë të rritet zhvillimi ekonomik, gjenerimi i vendeve të punës të cilat janë prioritet i Qeverisë së RKS por edhe niveleve lokale në Kosovë.

Zhvillimi i strategjisë së sektorit të turizmit për Komunën e Podujevës është një dokument i cili është realizuar në harmoni me dokumentet tjera strategjike në nivelin lokal dhe qendror. Strategjia e Komunës së Podujevës është realizuar në mbështetjen e këtyre dokumenteve zhvillimore, siç janë: "Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021", që përmban një mori masash për të siguruar një sistem të qëndrueshëm zhvillimor në nivel lokal, e që janë: kompletimi i kornizës së dokumenteve hapësinore në nivel lokal, menaxhimi efikas i shërbimeve publike, planifikimi më i mirë i politikave, përgatitja e kapitalit njerëzor, promovimi i rëndësisë së shkollave profesionale dhe ndërlidhja e shkollimit me tregun e punës, shpenzimi i drejtë i parasë publike, promovimi i tregut të tokës dhe resurseve të tjera që mundësojnë rritje

ekonomike.¹ Dokument tjetër në të cilin është mbështetur hartimi i strategjisë së turizmit për Komunën e Podujevës është “Strategjia për vetëqeverisje lokale 2016-2026” Kjo strategji parasheh masa multisektoriale në drejtim të fuqizimit të sistemit të vetëqeverisjes lokale, duke nënkuptuar edhe alternativat për rritjen e autorizimeve të komunave në fushën e zhvillimit ekonomik lokal. Me aprovimin e kësaj strategjie dhe planit të veprimit janë dhënë orientimet afatgjata programore për nivelin qendror dhe atë lokal, për të rikonfirmuar rëndësinë e pushtetit lokal si një mekanizëm i pazëvendësueshëm në zgjidhjen e problemeve praktike të qytetarëve.² Një dokument tjetër në të cilin është mbështetur strategjia e Komunës së Podujevës për sektorin e turizmit është “Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (PKZMSA)”, që parasheh përmirësimin e veprimtarisë së organeve lokale në përmbushjen e mandatit të tyre ligjor, sigurimin e zbatimit të ligjshmërisë me rastin e veprimtarisë së tyre normative, fuqizimin e transparencës komunale, zbatimin efikas të projekteve kapitale, nxitjen dhe zhvillimin përmes programeve të bashkëpunimit ndërkomunal, ndërkufitar dhe transnacional, forcimin e kapaciteteve të administratës lokale, etj.³ Strategjia e turizmit të Podujevës si dokument strategjik për sektorin e turizmit mbështetje gjenë edhe në “Kornizën Afatmesme Buxhetore Komunale (KABK)”, e cila ofron një analizë të hollësishme të të hyrave dhe shpenzimeve të Komunës. Shpenzimet duhet të planifikohen për të pasqyruar prioritetet strategjike për zhvillimin e vazhdueshëm të Komunës. KABK siguron një mekanizëm të dobishëm përmes të cilit prioritetet e identifikuar në dokumentet strategjike të komunës mund të integrohen më mirë në procesin e buxhetit.⁴ “Strategjitë e veprimit në nivel lokal – Komuna e Podujevës” ka qenë dokument mbështetës në hartimin e strategjisë së sektorit të turizmit. Dokument ky që në njërin nga objektivat strategjike ka edhe promovimin e aktiviteteve kulturore dhe sportive në funksion të zhvillimit të turizmit.⁵

Profili i Komunës së Podujevës

¹ Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021

² Strategjia për vetëqeverisje lokale 2016-2026

³ Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (PKZMSA)

⁴ Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale (KABK)

⁵ Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal – SZHEL

Komuna e Podujevës shtrihet në pjesën verilindore të Republikës të Kosovës. Në jug kufizohet me Komunën e Prishtinës, ndërsa në perëndim kufizohet me Obiliqin, Vushtrrin, Mitrovicën dhe Leposaviqin. Në veri dhe lindje kufizohet me Serbinë. Gjatësia totale e vijës kufitare është 172.5 km. Kufiri i komunës kalon nëpër terrene malore, afër vijave ujë-ndarëse apo nëpër to dhe në pjesë të ulëta nëpër disa qafa malore, ose nëpër lugina duke i prerë tërthorazi. Me Prishtinën, gjatësia e kufirit është 37.39 km, i cili kalon nëpër terrene kodrinore – malore dhe nga ana perëndimore lëshohet në luginën e lumit Llap, në fshatin Lupç i



Figura 1. Pozita gjeografike e Rajonit të Podujevës në hartën e Kosovës.

Poshtëm. Nga kjo pikë kufiri merr drejtim verior dhe kufizohet me Komunën e Obiliqit, në gjatësi prej 2.8 km. Në veri kufizimi vazhdon me Komunën e Vushtrrisë, duke u ngritur drejt maleve të Kopaonikut, me gjatësi prej 18.9 km. Me Mitrovicën, gjatësia e kufirit është 17.52 km, ndërsa me Leposaviqin, gjatësia e kufirit është 7.7 km, duke u rritur gjithnjë lartësia mbidetare. Me Serbinë (veri dhe lindje) gjatësia e kufirit është 90.9 km. Lartësia mbidetare e kufirit perëndimor të Komunës së Podujevës është mjaft e lartë ngase shtrihet në pjesën jugore të maleve të Kopaonikut, ku arrin pikën më të lartë në majen e Shatoricës (Komuna e Leposaviqit) me lartësi mbidetare prej 1,770 m. Pika më e ulët e kufirit është në pjesën jugore – në fshatin Lupç i Poshtëm (në luginën e lumit Llap) me rreth 550 m. Territori i Komunës së Podujevës ka shtrirje të gjatësisë në drejtim V, VP dhe J, JL, me një sipërfaqe prej 633 km² dhe njëherit është komuna me territorin më të madh në Republikën e Kosovës.

Qyteti i Podujevës, si qendër komunale, ndodhet pothuajse në qendër të territorit të Komunës (Llapit) që paraqet një përparësi, ngase vendbanimet përreth kanë qasje më të mirë për shërbime komunale. Mirëpo vendbanimet periferike kanë ngelur në pozitë më të pafavorshme në aspektin ekonomik dhe infrastrukturor, e sidomos vendbanimet në pjesën veriore (Murgull, Reçicë, Pollatë, Sllatinë, etj.) dhe disa vendbanime në pjesën jug – lindore (Muhazob, Bërvenik, Turuçicë, Metergofc) gjë që ka ndikuar në shpërngulje të madhe të banorëve nga këto fshatra, sidomos pas vitit 1999, megjithë pasuritë dhe potencialet e mëdha turistike që kanë. Pjesa jugperëndimore e komunës është në pozitë shumë më të mirë gjeografike, ngase lidhet me

kryeqendrën e Kosovës – Prishtinën. Në përgjithësi territori i Komunës së Podujevës ka pozitë të mirë gjeografike, sepse nëpër këtë territor kalojnë rrugët tranzitore (auto - rrugë dhe hekurudha) përmes së cilave Llapi lidhet me Prishtinën, Fushë Kosovën, magjistralen e Adriatikut dhe me Shkupin, ndërsa në verilindje – përmes qafës së Përpellacit me Republikën e Serbisë.

Klima e Rajonit të Podujevës klasifikohet si klimë e mesme - kontinentale, mirëpo për shkak të pozitës së vet gjeografike dhe për shkak të relievit të saj, cilësohet me disa veçori klimatike në hapësirën e Kosovës.

Muaji më i ftohtë është janari, kurse muajt më të ngrohtë janë korriku dhe gushti. Temperatura e ftohtë më ekstreme është regjistruar në janar me -27.2°C , ndërsa temperatura maksimale prej 37.0°C është shënuar në muajin gusht. Amplituda ekstreme për këtë periudhë (janar - gusht) është 64.2°C . Sasia mesatare e të reshurave në Komunën e Podujevës është 697 mm, që është nën mesataren e Kosovës (784 mm). Muaji me të reshura më të shpeshta është muaji maj me $77,5 \text{ l/m}^2$, ndërsa muaji me të reshura më të pakta është muaji mars, me $42,3 \text{ l/m}^2$. Vjeshta, është stina me lagështin më të madhe ndërsa më e thata është vera me 147.9 mm të reshura.

Popullsia e Komunës së Podujevës jeton në gjithsej 79 vendbanime, prej tyre 78 janë fshatra ndërsa qendra e tyre është qyteti i Podujevës. Në Komunën e Podujevës jetojnë 88,499 banorë, që do të thotë se rreth 35% e popullsisë së tërësishme jeton në qytet, ndërsa në të gjitha vendbanimet e tjera jetojnë rreth 65% e banorëve. Nga numri total i banorëve, meshkuj janë rreth 44,955 ndërsa femra janë 43,544.⁶

Relievi është një faktor i rëndësishëm fiziko – gjeografik për çdo hapësirë, andaj në planet zhvillimore komunale trajtohet aspekti i përshtatshmërisë së tij për zhvillim.

Në territorin e Komunës së Podujevës hasen forma të ndryshme të relievit, që janë krijuar nga faktorë të ndryshëm natyrorë. Kryesisht dallohen tri tërësi të relievit: në perëndim shtrihen malet e Shalës së Bajgorës, me lartësi deri në 1,879 m (Maja e mprehtë - Ostrokopja), ndërsa në anën veriore gjendet masivi i Maleve të Albanikut (Kopaunikut), në pjesën lindore shtrihen malet, lartësia e të cilave nuk kalon 1,297 m (Kepi i Uglarit, Përpellacit, Batllavës, Brainës, Shakovicës etj). Të gjitha këto male ndahen njëra prej tjetrës në forma të izoluara kodrinore dhe malore dhe

⁶ ASK – Agjensioni i statistikave të Kosovës

shpesh me lumenj malor të cilët kanë formuar lugina të thella sidomos në pjesën veriore dhe perëndimore të rajonit të Llapit prandaj edhe është më pak e populluar se sa pjesa lindore dhe ajo jugore. Në mes të këtyre dy tërësive malore (lindje-perëndim) shtrihet fushëgropa e Llapit në drejtim veri – lindje me gjatësi 31 km dhe sipërfaqe prej 147 km².

Fusha e Llapit është një krahinë bujqësore, në të cilën lavërtaria, blegtoria e më pak pylltaria përbëjnë veprimtarinë kryesore ekonomike të saj⁷.

K. Podujeve & SPINP Agency

⁷<https://kk.rks-gov.net/podujeve/podujeve-2/pozita-gjeografike/>

METODOLOGJIA E HARTIMIT TË STRATEGJISË

Hartimi i strategjisë së turizmit për Komunën e Podujevës është një projekt cili është nënkontraktuar për zhvillim nga kompania konsulente "Spin Agency". Kompania në fjalë është kontraktuar nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik në Komunën e Podujevës, ekspertët e kompanisë në mbështetje të stafit ndihmës kanë vazhduar me aktivitetet vijuese në fazat si në vijim:

Faza e parë: Vlerësimi i gjendjes aktuale.

Ekspertët së bashku me grupin ndihmës kanë qenë të fokusuar në hulumtimin dhe identifikimin e zonave me karakter turizmi. Kjo fazë është realizuar nga vizitat në teren, bashkëbisedimi me qytetarë dhe njohës të fushave, nga ku të dhënat e mbledhura dhe të sistemuara janë dorëzuar për fazat e mëvonshme.

Faza e dytë: Krijimi i Punëtorive.

Në këtë fazë është bërë ndarja e ekspertëve dhe stafit ndihmës në punëtori. Numri i punëtorive të përcaktuara ishte 3 (tri) punëtori dhe 1 (një) fokus grup.

Punëtorja e parë ka qenë e përqëndruar në vlerësimin e gjendjes aktuale në faktorët si në vijim:

1. Skanimin e mjedisit turistik 2. Identifikimin e akterëve në zhvillimin e turizmit dhe 3. Opcionet e sigurimit të kapitalit për zhvillimin e turizmit.

Punëtorja e dytë ka vlerësuar mundësitë dhe destinacionet për zhvillimin e turizmit duke u mbështetur në këta faktorë: 1. Ofrimin e mbështetjes së fushave ekzistuese të turizmit. 2. Zhvillimi i programeve dhe projekteve të reja në fushën e turizmit dhe 3. Tërheqja e investimeve në zhvillimin e turizmit.

Punëtorja e tretë është përqëndruar në analizimin e programeve dhe projekteve konkrete të gjeneruar nga punëtorja e dytë në funksion të faktorëve vijues: 1. Dobishmërinë e mbështetjes së projekteve ekzistuese. 2. Prioritetizimin e programeve dhe projekteve të propozuara.

Fokus grupi është përbërë nga 6 anëtarë të cilet në mbështetje të moderatorit të takimit kanë ofruar kontributet konkrete me njohuritë, eksperiencën dhe propozimet e tyre.

Krejt në fund ekspertët e involvuar në hartimin e strategjisë kanë bërë krahasimin e të gjeturave në punëtorinë e tretë dhe janë marrur sugjerimet nga fokus grupi dhe është hartuar dokumenti final.

Vizioni

Komuna e Podujevës në bashkëpunim me akterët relevant në kuadër të zhvillimit ekonomik lokal, theks të veçantë i kanë kushtuar sektorit të turizmit duke e caktuar atë si një faktor me më peshë në hartimin e vizionit të saj.

Deklarata e vizionit për Komunën e Podujevës është gërshetim i interesit të përbashkët dhe “hartë” e përcaktimit të objektivave strategjike në funksion të zhvillimit të përgjithshëm ekonomik. Objektivat strategjike paraqesin derivime të shkoqitura nga vizioni të cilat nëpërmjet planeve konkrete duhet të jetësohen me qëllim të realizimit të vizionit.

Krijimi i një vizioni për turizmin si pasqyrim afatgjatë i orientimit zhvillimor të këtij sektori është mbështetur në dokumentet relevante të nivelit komunal me sa vijon:

- Strategjia për Zhvillim ekonomik lokal 2016-2018;
- Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021 (SKZH);
- Plani Zhvillimor Komunal;

Në mbështetje të të gjitha dokumenteve të mësipërme është lehtë e konkludueshme se turizmi edhe në nivel kombëtar edhe në nivel lokal parashihet që të jetë një nga promotorët kyç të zhvillimit ekonomik. Komuna e Podujevës ka resurse të tilla me karakter turizmi gjë që këtë vend e bën një nga vendet më atraktive për turizëm ditor në sezonin e verës në nivel nacional. Në realizim të qëllimit të promovimit të turizmit është i nevojshëm mobilizimi i të gjithë akterëve relevant në funksion të promovimit të produkteve turistike dhe ofrimit të kushteve për investime nga partneritetet publiko-private.

Deklarata për Vizionin e Komunës së Podujevës është definuar si:

“Podujeva destinacion i gërshetimit të së kaluarës antike dhe të tashmes moderne, i bukurive natyrore të paprekura dhe të ndërtuara nga vetë njeriu, traditës dhe mikëpritjes së lashtë shqiptare dhe bashkëjetesës ndëretnike multikulturore.”

GJENDJA AKTUALE

Komuna e Podujevës ka potenciale të shumta në aspektin e zhvillimit të turizmit. Gjatë punës në terren në bashkëpunim me akterë tjerë siç janë: komuniteti, shkollat, kryetarë të fshatrave, Shoqata, OJQ dhe persona fizikë dhe juridik kemi bërë prioritetizimin e pikave me interes të veçantë turistik në Komunën e Podujevës. Si pika kryesore përmendim: Liqenin e Batllavës, Banja e Shakovicës, Vendenisi, zonat malore të Podujevës sidomos rrjedha e sipërme e lumit Llap, objektet fetare, trashëgimitë kulturore dhe fetare, zonat me interes ekoturistik, sportiv, rekreativ, shëndetësor, etj.

Të gjitha pikat me interes të veçantë kanë mangësi në aspektin infrastrukturor, sinjalistikë, informim të pamjaftueshëm, etj.

Turizmi dhe hoteleria

Komuna e Podujevës karakterizohet me potenciale të shumta të zhvillimit të turizmit. Gjeomorfologjia e territorit të Komunës së Podujevës e karakterizuar me dy masive malore, Albanikun dhe Gollakun, si dhe fushëgropa e Llapit së bashku me lumin e Llapit dhe Liqenin e Batllavës i japin vlerë konkurruese Komunës së Podujevës në Kosovë. Liqeni i Batllavës, i cili furnizon me ujë të pijes katër komuna, si: Podujevën, Prishtinën, Fushë-Kosovën dhe Obiliqin, njëkohësisht ofron kushte të mira për turizëm. Gjatë sezonit veror ky liqen tërheq mijëra vizitorë të cilët vijnë për pushime në hapësirat përgjatë tij, ku në shumicën e rasteve manifestohet edhe me krijimin e problemeve të caktuara mjedisore. Mirëpo, hoteleria rezulton që nuk është mjaft e zhvilluar. Në Komunën e Podujevës janë 470 biznese hoteliere, nga 4854 biznese⁸ sa është edhe numri total i tyre në territorin e Komunës së Podujevës, deri më 31.12.2018. Pjesëmarrja e hotelerisë dhe numrit të bizneseve të regjistruara gjithsej në Komunën e Podujevës është rreth 9.68%. Ndërsa, shtrirja e bizneseve hoteliere është e shprehur kryesisht përgjatë rrugëve të karakterit nacional (magjistrale–regjionale), rrugëve të asfaltuara, si dhe objekteve dhe peisazheve të tjera me atraktivitet të veçantë. Vetëm në qytetin e Podujevës janë të përqendruara rreth 90% e bizneseve hoteliere kurse pjesa tjetër (10%) në vendbanimet e tjera periferike dhe rurale.

⁸ ARBK (Agjencioni i Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës)-Njësia Podujevë

Rëndësi dhe vlera të theksuara turistike, në Komunën e Podujevës, kanë edhe objektet ose monumentet e trashëgimisë kulturore, të cilat janë të krijuara në periudha të ndryshme historike. Gjithashtu, vlerësohet edhe trashëgimia më e re që ka vlerë të veçantë, si: Kulla e dëshmorit të kombit- Zahir Pajaziti, si dhe shumë lapidarë të të rënëve për çlirimin e Kosovës, të cilat monumente e identifikojnë këtë komunë.⁹

<i>Pika turistike</i>	<i>Resurs</i>	<i>Fshati</i>	<i>Ekoturistik</i>	<i>Historik/Fetar</i>	<i>Rural</i>	<i>Malor</i>	<i>Ndërkufitar</i>	<i>Shëndetësor</i>	<i>Kongresial</i>
<i>Lumi Llap</i>	Ujor	Gjatësi 84 km	+		+				
<i>Liçeni i Batllavës</i>	Ujor	Orllan	+		+			+	
<i>Burimi i Lumit Llap</i>	Ujor	Murgull	+		+			+	
<i>Vrella e Revuçit</i>	Ujor	Revuq	+					+	
<i>Lumi i Kaqandollit</i>	Ujor	Popovë	+					+	
<i>Lumi i Terrnavicës</i>	Ujor	Terrnavicë							
<i>Lumi i Dumnicës</i>	Ujor	Dumnicë							
<i>Lumi i Sllatinës</i>	Ujor	Sllatinë							
<i>Ujevarat e Segashit</i>	Ujor	Segash	+					+	
<i>Ujevarat e Muhazobit</i>	Ujor	Muhazob	+					+	
<i>Quka e Braines</i>	Malor	Brainë	+					+	
<i>Maja e Metergocit</i>	Malor	Metergoc	+				+	+	
<i>Shotorri</i>	Rural	Gllamnik	+					+	
<i>Quka e Drazhnjes</i>	Malor	Drazhnje	+					+	
<i>Kodra e qenve</i>	Rural	Buricë/Kunushevc	+						
<i>Kodra e Bajrakut</i>	Rural	Buricë/ Kunushevc	+						
<i>Maja e Majacit</i>	Malor	Majac	+				+	+	
<i>Malet e Popovës/ Lupqit</i>	Malor	Popovë/Lupq i Epërm							
<i>Musinca</i>	Malor	Murgull	+			+	+	+	
<i>Kroni i Vullakut</i>	Malor	Murgull	+			+	+	+	
<i>Bellosica Momumente te vjetra/ burimi i ujit sulfurik</i>			+	+		+		+	
<i>Kalaja ne Bellosicë</i>	Malor			+					
<i>Lokaliteti arkeologjik 'Vërhllab'</i>	Historik	Bellasicë		+					
<i>Varret e vjetra, gjurmët e kishës</i>	Historik	Pollatë		+					
<i>Lokaliteti Arkeologjik - Çuka e Braines</i>	Historik	Brainë		+	+	+			
<i>Germadhat e Kishes,perandori Konstantin dhe Perandoreshes Jelena</i>	Historik	Orllan		+					

⁹ ASK – Agjensioni i statistikave të Kosovës

<i>Kisha e vjetër e braktisur e Shën Arkangjell Mehillit</i>	Historik	Rakinicë	+		
<i>Lokaliteti arkeologjik Vindenis 'Polanicë'</i>	Historik	Gllamnik	+		
<i>Germadhat e kishës se Marise se Zjarrit - Mesjete</i>	Historik	Batllavë	+		
<i>Lokaliteti Arkeologjik - Kalaja (Qyteza)</i>	Historik	Lupç i Poshtëm	+		
<i>Germadhat e kishës se Shën Arkangjelit</i>	Historik	Bradash	+		
<i>Lokaliteti neolitik 'Gumnishtë'</i>	Historik	Surkish	+		
<i>Kalaja e Ballocit</i>	Historik	Balloc	+		
<i>Germadhat e Kishës së vjetër Shtëpi banimi</i>	Historik	Reqicë	+		
<i>Kulla e Xhemail Haxhiut</i>	Historik	Podujevë	+		
<i>Shtëpi banimi- Avdullah Avdullahu</i>	Historik	Herticë	+		
<i>Kishëz</i>	Historik	Llaushë e Ulët	+		
<i>Xhamia e Brainës</i>	Historik	Rakinicë	+		
<i>Mulliri, Metehi</i>	Historik	Brainë	+		
<i>Pojata e Avdyl Shabanit</i>	Historik	Metehi	+		
<i>Flladniku I Avdyl Shabanit</i>	Historik	Metehi	+		
<i>Xhamia e Dumnicës</i>	Historik	Dumnicë	+		
<i>Kulla e Nazif Muratit</i>	Historik	Popovë	+		
<i>Mulliri i Dem Ahmetit</i>	Historik	Reqicë	+	+	+
<i>Shtëpi Banimi - Sabit Hamiti</i>	Historik	Reqicë	+		
<i>Kulla e Dem Ahmetit</i>	Historik	Reqicë	+	+	+
<i>Shtëpi banimi - Musa Hamiti</i>	Historik	Reqicë	+		
<i>Shtëpi banimi- Hasan Ramadani</i>	Historik	Shajkoc	+		
<i>Mulliri në Majac</i>	Historik	Majac	+		
<i>Koshi i Basri Rrahmanit</i>	Historik	Lladoc	+		
<i>Ndërtesa e Kuvendit Komunal</i>	Historik	Podujevë	+		
<i>Mulliri i lagjes Azemi</i>	Historik	Pollatë	+		
<i>Shishe, Kupë, Vazo, Sarkofag, Byzylyk, Broke</i>	Historik	Gllamnik	+		
<i>Kulla e Zahir Pajazitit</i>	Historik	Rakinicë	+		
<i>Kompleksi Memorial Baza e Parë e UÇK-së</i>	Historik	Lladoc	+		
<i>Kompleksi Memorial</i>	Historik	Penuh	+		

Tabela 1. Pikat turistike në Komunën e Podujevës.

Burimi: MKRS dhe Bashkëbisedimi me njohës të fushave përkatëse dhe Sistemit i Operatorit ekonomik

Infrastruktura rrugore

Në Komunën e Podujevës ka një numër të madh të rrugëve të cilat ndahen sipas kategorive:

TIPI I RRUGËS	GJATESIA KM
Rrugë magjistrale	18.80
Rrugë regjionale	80.00
Rrugë lokale	370.10
Rrugë të pakategorizuara	756.30
TOTAL RRUGË	1,225.00

Tabela 2. Gjatësia e rrugëve të Komunës së Podujevës.
Burimi: ASK- Agjensioni i statistikave të Kosovës

Arsimi në Komunën e Podujevës

Komuna e Podujevës një trevë me histori të lavdishme por me një arsimim jo të hershëm, duke u bazuar me problemet me të cilat është ballafaquar populli shqiptar dhe presionet e ndryshme, prap se prap arsimimi dhe edukimi nuk është ndalur, kështu në Komunën e Podujevës shkolla e parë është hapur gjatë periudhës së Luftës së Dytë Botërore. Shkollat e para në Llap ishin: Shkolla fillore “Abdyl Frashëri” Halabak, Shkolla fillore “Skënderbeg” Podujevë, Shkolla fillore “Azem Bejta” Kërpimeh, Shkolla fillore “Ismail Qemali” Dumnicë, Shkolla fillore “Bajram Curri” Sfeçël etj. Këto shkolla ishte e pamundur të funksiononin në mungesë të mësuesëve dhe mësuesit e parë të shkollave në Llap ishin: Ismail Thaçi, Sylë Llapashtica, Hashim Latifi, Hashim Kuleta, Hamdi Uka, Hamit Sejdiu, Faik Zeneli etj.¹⁰

Rrjeti hekurudhor

Rrjeti hekurudhor në Komunën e Podujevës është i karakterit nacional dhe ka shtrirje në pjesën qendrore të Komunës së Podujevës, përkatësisht i takon kategorisë së komunikacionit magjistrat, i cili i lidhë dy shtete fqinjë (Republikën e Kosovës dhe Serbinë). Kjo linjë hekurudhore kalon në pjesën qendrore të Komunës së Podujevës me gjatësi prej 22 km. Aktualisht kjo linjë hekurudhore është në tërësi jo funksionale dhe e pashfrytëzueshme.¹¹

¹⁰ <https://kk-arkiva.rks-gov.net/podujeve/Temat/Education.aspx>

¹¹ ASK-Agjensioni i statistikave të Kosovës

Transporti publik

Në nivel lokal organizohet nëpërmjet autobusëve, kombi-busëve, auto-taksive. Shikuar nga numri i vendbanimeve që kanë transport publik, nga 78 vendbanime sa ka Komuna e Podujevës, 40 prej tyre kanë qasje në transport publik nëpërmjet autobusëve, 21 nëpërmjet kombi-busëve dhe 17 vendbanime nuk kanë qasje në transport publik.

Telefonia fikse

Rrjeti i telefonisë fikse në Komunën e Podujevës është i lidhur nëpërmjet fibrës optike, i cili i përket linjës së trasesë Prishtinë–Podujevë. Ky rrjet menaxhohet nga njësi e PTK-së, në Podujevë, e cila ka centralin e lidhur me fibrin optik dhe ka kapacitet total 7,200 çifte. Poashtu në territorin e Podujevës operon edhe një operator privat në ofrimin e telefonisë fikse (IPKO). Momentalisht, shfrytëzohen 1,771 çifte. Shtrirja e rrjetës së telefonisë fikse ekzistuese mundëson qasje të mbi 46.8 % të popullsisë në rrjetin e telefonisë fikse.

Telefonia mobile

Telefonia mobile në territorin e Podujevës është e mbuluar mjaft mirë. Pothuajse të gjitha vendbanimet e Podujevës kanë qasje në shërbimet e telefonisë mobile, të cilat ofrohen nga tre operatorët e licencuar nga ART-ja. Të tre operatorët mobil kanë të shpërndara antena individuale në lokacione të ndryshme të komunës.

Mediat lokale

Podujeva ka momentalisht dy radio lokale "Radio Llapi" dhe "Radio Vizioni" dhe Televizionin lokal "TV Llapi", të cilat thuhet se kanë shtrirje (dëgjueshmëri dhe shikueshmëri) të plotë në tërë territorin e Komunës së Podujevës.

Interneti

Interneti në territorin e Podujevës ka një mbulueshmëri dhe shtrirje mjaft të gjerë. Pjesa urbane e Komunës së Podujevës është e kyçur me internet dhe interneti është i shtrirë në çdo pjesë të saj, ndërsa disa pjesë rurale më të thella, nuk kanë qasje në internet.

Pyjet

Deri vonë Komuna e Podujevës është identifikuar si një prej komunave me sipërfaqe të mëdha të

pyjeve në nivel të Kosovës, ndërsa pas luftës (1999) u bë degradimi dhe shkatërrimi i madh i pyjeve. Kështu që në të ardhmen i mbetet komunës, që të menaxhojë pyjet, në mënyrë që të ruhen ato sipërfaqe që kanë mbetur pa u shkatërruar si dhe të bëhet pyllëzimi i sipërfaqeve të shpyllëzuara. Pyjet në Komunën e Podujevës kapin sipërfaqe prej 29.050 ha, prej të cilave:

Spektori shoqëror - 17.600 ha

Spektori privat - 11.450 ha.

Tokat bujqësore

Komuna e Podujevës përfaqësohet me tipa të llojëllojshëm të tokave: toka aluviale, deluviale, rendzinë, ranker, e murme argjilore liqenore, e mesme e kuqrrëmte, pseudogleje, etj.

Tokat aluviale si toka hidromorfike të cilësisë së lartë shtrihen përgjatë lumit Llap, si dhe tokat tjera që kanë cilësi të mira kultivimi siç janë: deluviale, e mesme e kuqrrëmte, rendzinat shtrihen po ashtu në fushëgropën e Llapit me trashësi mbi 25 - 80 cm.

Tipi i llojeve tjera të tokës ka përhapje në tërë territorin e komunës si: rankere, pseudogleje, e murme argjilore etj.

Burimet ujore

Territori i Komunës së Podujevës ka një rrjet hidrografik, i cili i drenon ujërat në drejtim të pellgut të Detit të Zi. Ujërat sipërfaqësor paraqiten në formë të përrrenjve, burimeve dhe lumenjve. Në këtë territor buron dhe shtrihet lumi Llap, i cili njëkohësisht është edhe dega më e rëndësishme e lumit Sitnica. Lumi Llap buron nga malet e Albanikut, mirëpo, si degë duhet të merret lumi Murgulla. Gjatësia e këtij lumi është 61 km, kurse deri në grykë derdhje të lumit Sitnica gjatësia është 82,7 km. Gjatë reshjeve intensive dhe shkrirjes së borës gjatë stinës së dimrit, kur temperaturat rriten, lumi del nga shtrati duke shkaktuar përmytje, duke dhe dëme të konsiderueshme. Lumenj të tjerë janë: Lumi Dumnica, Batllava, dhe Lumi i Kaqandollit. Treva e Llapit është e pasur edhe me ujëra termo-minerale, si: Burimi mineral në fshatin Sallabajë dhe burimet termo - minerale në Shakovicë.¹²

¹²APK – Agjensioni i Pyjeve të Kosovës

Bota bimore dhe shtazore- llojet dhe përhapja e tyre

Ndërtimi gjeologjik, lartësia mbidetare, si dhe kushtet klimatike kanë bërë që rajoni i Podujevës të ketë një llojllojshmëri mjaft të pasur me botën bimore dhe shtazore.

Prej bimëve drunore dallohen pyjet gjethrënëse si: ahu (*Fagus sylvatica*), qarri (*Quercus cerris*), bungu, shkoza (*Carpinus orientalis*). Përhapje më të kufizuara kanë llojet tjera, që paraqiten si të vetmuara si: brekia, bliri (*Tilia kordata*), frashri etj.

Prej bimëve shkurre hasim: thana (*Cornus mas*), murrizi (*Crataegus monogyna*), kaça (*Rosa canina*), manaferra e egër (*Rubus fruticosus*), shtogu (*Sambucus nigra*), kulumbria (*Prunus spinosa*), lajthia (*Corylus avellana*), në vise të larta fieri shqiponjë (*Pteridium aquilinum*) etj.

Prej bimëve barishtore hasim: çaji i malit (*Origanum vulgare*), kantarioni (*Hypericum perforatum*), kamomili (*Matricaria chamomila*), dredhëza (*Fragaria vesca*), kohëve të fundit kultivohet edhe shafrani organik si bimë me vlera të veçanta.

Në hapësirat e rrafshita të komunës, në fushëgropën e Llapit, zakonisht rritet shelgu (*Salix alba*) në brigje të lumenjve, si dhe plepi. Bimë të ulëta, si: lulëkuqja që rritet zakonisht në grunaja (*Papaver rhoeas*), hithi (*Urtia dioica*) formacionet e livadheve si tërfili dhe shkurret e rralla, ka mjaft.

Nga bota shtazore vlen të përmendim: ujku (*Canis lupus*), derri i egër (*Aus strofa*), dhelpra (*Vulpes vulpes*), lepuri (*Lepus europaeus*), iriqi (*Ernaceus europeus*), kaprolli (*Capreollus chrysaetos*) i cili dikur ka qenë mjaft i përhapur.

Prej shpezëve jetojnë mjaft lloje si: trishtili kokëzi (*parus major*), zogu i malit, pëllumbi i egër (*columbia livia*), qukapikthi (*dryobates major*), laraska (*pica pica*), qyqja (*cuculus canorus*) etj. Shpezë grabitqare që jetojnë janë shqiponja e zezë (*aquilachyretos*), petriti (*malco tinnunculus*). Shpezë shtegtarë që jetojnë janë dallëndyshja, lejleku, etj.

Në lumenj jeton gjarpri i ujit (*Natrix natrix*), i gurit (*Vipera ammodytes*), bollujca (*Tropidonatus natrix*), kërmilli i vreshtës (*Helix pomatia*), breshka e rëndomtë (*Testudo bermanni*). Peshq ka disa lloje: trofta (*Salmo trutta m. Fario*) mustaku (*Barbus barbus*), bërcoku, mlyshi (*Squalius cephalus*), krapa (*Cyprinus carpio*), shtuka (*Esox lucius*) etj. Insekte ka shumë lloje siç janë: fluturat (*Lepidoptera*), milingonat, që bëjnë koloni dhe janë disa lloje merimanga, kaçadreri (*Lucanus cervus*), etj.¹³

¹³AMMK-Agjensioni për Mbrojtjen e Mjedisit në Kosovë

BOTA BIMORE			BOTA SHTAZORE		
Bimë drunore	Bimë shkurre	Bimë barishtore	Shtazë / gjitarë	Shpendët	Shtazë tjera
ahu (<i>Fagus sylvatica</i>)	thana (<i>Cornus mas</i>)	Lulëkuqja	ujku (<i>Canis lupus</i>)	trishtili kokëzi (parus major)	gjarprii ujit (<i>Natrix natrix</i>), i gurit (<i>Vipera ammodytes</i>), bollujca (<i>Tropidonatus natrix</i>)
qarri (<i>Quercus cerris</i>)	murrizi (<i>Crataegus monogyna</i>)	grunaja (<i>Papaver rhoeas</i>)	derrri egër (<i>Aus strofa</i>)	zogu i malit	kërmillii vreshtës (<i>Helix pomatia</i>)
bungu,	kaça (<i>Rosa canina</i>)	hithi (<i>Urtia dioica</i>)	dhelpra (<i>Vulpes vulpes</i>)	pellumbii egër	breshka e rëndomtë (<i>Testudo bermanni</i>).
shkoza (<i>Carpinus orientalis</i>):	manaferra e egër (<i>Rubus fruticosus</i>)	tërfili	lepuri (<i>Lepus europaeus</i>)	(columbia livia),	Peshq: trofta (<i>Salmo trutta m. Fario</i>)
brekia,	shtogu (<i>Sambucus nigra</i>)	kamomila	iriqi (<i>Ernaeus europeus</i>)	qukapikthi (<i>dryobates major</i>)	mustaku (<i>Barbus barbus</i>),
		(<i>Chamomila matricaria</i>)	kaprolli (<i>Capreollus chrysaetos</i>)	laraska (<i>pica pica</i>)	bërcoku,
bliri (<i>Tilia kordata</i>),	kulumbria (<i>Prunus spicosa</i>)			qyqja (<i>cuculus canorus</i>)	mlyshi (<i>Squalius cephalus</i>),
frashri	lajthia (<i>Corylus avellana</i>)			Shpezë grabitqare shqiponja e zezë (<i>aquilachyretos</i>),	krapi (<i>Cyprinus carpio</i>),
shelgu (<i>Salix alba</i>)	fieri shqiponjë (<i>Pteridium aquilinum</i>)			petriti (malco tinnunculus).	
plepi (<i>Propulus</i>)				Shpezë shtegtarë	shtuka (<i>Esox lucius</i>)
				Dallëndyshja	Insekte: fluturat (<i>Lepidopterat</i>),
				lejleku	milingonat,
				Thellënza	merimanga,
					kaçadreri (<i>Lucanus cervus</i>)
					makroozobentosii lumenjëve, përrockave etj.

Tabela 3. Llojet e botës bimore dhe asaj shtazore të përhapura në Komunën e Podujevës.
Burimi: Agjensioni Mbrojtjes së Mjedisit & Plani Lokal për Veprim në Mjedis PLVM-Podujevë

Turizmi Kulturor

Podujeva dikur qytezë e vjetër e krahinës së Llapit, sot është shndërruar në një qytet të bukur e qendër me rëndësi ekonomike, arsimore, fregtare, turistike, politike, kulturore e sportive, joshëse për llapjanët, kosovarët dhe të huajt. Në Podujevë në ditët e sotme kemi një përfshirje të plotë të të gjitha komuniteteve në jetën socio-kulturore dhe ekonomike gjë që flet për një nivel të lartë të bashkëpunimit kulturor dhe ndëretnik si dhe të atij ndërfetar.

Turizmi sot është një komponent madhor në rritjen ekonomike duke stimuluar një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, veçanërisht në zonat ku ka koleksione, monumente nga trashëgimia kulturore-historike, komponent ky i cili është në një masë të madhe i varur edhe nga mjedisi i cili mund të jetë tërheqës për vizitorin dhe mund të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në ekonomitë e vogla lokale.

Në zhvillimet e sotme turistike në Kosovë, një vend të veçantë e zënë edhe objektet muzeore, pavarësisht mungesës së infrastrukturës ligjore. Prandaj edhe ne, rëndësi specifike duhet t'i japim themelimit të

muzeut Arkeologjiko-Etnografik si pikë turistike kyçe e qytetit tonë. Përmes këtij muzeu synohet të paraqitet një rrjedhje historike, që nga kohërat më të lashta e deri tek historia e re (lufta e fundit 1997-1999).

Komuna e Podujevës është shumë e begat me pasuri të trashëgimisë kulturore: lokalitete arkeologjike, objekte banimi, objekte kulti, komplekse memoriale që paraqesin historinë e saj në periudha të ndryshme kohore dhe që i sigurojnë asaj një potencial serioz për zhvillimin e turizmit kulturor. Këto asete që deri më sot konsideroheshin vetëm si pjesë e një tretmani (përshkrues) historik, kjo për shkak të pamundësisë financiare të pushtetit lokal për të ndërhyrë në jetësimin e tyre si dhe tranzicionit nëpër të cilin kaloi vendi ynë. Ndërsa sot është koha që këto vlera t'i trajtojmë dhe t'i përdorim në të mirë të zhvillimit të shoqërisë tonë.

Në zhvillimin e kësaj strategjie, një vend i veçantë duhet t'i kushtohet vlerave arkeologjike, specifikisht lokalitetit arkeologjik të "Vindenisit" që është me rëndësi nacionale për vendin tonë. Duke e ditur rëndësinë e tij kulturore-historike dhe shtrirjen e tij gjeografike mund të themi se e bënë lehtë të prekshëm për vizitorët. Koordinimi midis autoriteteve qendrore, lokale, organizatave joqeveritare vendore e ndërkombëtare, për hartimin dhe implementimin e një plani investiv për kthimin e këtij lokaliteti në një pikë turistike, do t'i shkonte për shtati jo vetëm komunës tonë, por edhe shtetit tonë. Me më pak rëndësi nuk janë edhe asetet tjera si: Lokaliteti arkeologjik Vendenis, Kulla e Demë Ahmetit, Xhamia e Brainës, Kalaja e Herticës etj... por që përmes planeve specifike për konservim dhe restaurim në një periudhë më afatgjatë synohet që edhe këto të revitalizohen. Vlenë të theksohet fakti se këto pika turistike janë të shpërndara gjithandej territorit të Komunës së Podujevës, e kjo është mirë për faktin se një lloj ndikimi ekonomik i tërthort, përfshin edhe banorët lokal, përmes shërbimeve të nevojshme lidhur me turizmin si: bujtina, restorante me ushqime tradicionale, transport, suvenire etj. Kështu që ndikimet e lartpërmendura pasqyrohen me punësim dhe të ardhura financiare. Poashtu për të siguruar një qëndrueshmëri të këtyre vlerave, duhet ndarja e një fondi për promovimin e aktiviteteve, ku përmes këtyre aktiviteteve synohet sensibilizimi i opinionit. Në këtë fond përfshihen edhe promocionet në rrjetet sociale, fletushkat e ndryshme, si dhe spotet publicitare.

Pra vërehet qartë se Komuna e Podujevës është e pasur me vlera kulturore, historike dhe që përmes kësaj industrie të butë mund të ndikojë në një ekonomi të qëndrueshme lokale. Andaj, është me rëndësi që ky potencial së bashku me një promovim më të mirë, plane investimi dhe burime njerëzore do të arrijë që turistët të mësojnë për thesaret e çmuara kulturore në Komunën tonë.

Trashgëmia kulturo-historike

Trashëgimia kulturore e Podujevës shfaq historinë e saj në periudha të ndryshme kohore. Podujeva dikur qytezë e vjetër e krahinës së Llapit, sot është shndërruar në një qytet të bukur e qendër me rëndësi ekonomike, arsimore, tregtare, turistike, politike, kulturore, sportive, joshëse për llapjanët, kosovarët, e të huajtë. Në Podujevë në ditët e sotme kemi një përfshirje të plotë të të gjitha komuniteteve në jetën socio-kulturore dhe ekonomike gjë që flet për një nivel të lartë të bashkëpunimit kulturor dhe ndëretnik poashtu edhe të atij ndërfetar.

Trashëgimia historike e komunës së Podujevës është shumë e pasur. Në Podujevë kemi një ndërthurje të të kaluara antike me të tashmën moderne. Vendbanimet e hershme në Komunën e Podujevës flasin për një zhvillim shumë të hershëm qysh nga antikiteti. Ajo me çka veçohet Komuna e Podujevës në aspektin kulturor është lokaliteti arkeologjik Vendenisi në fshatin Gllamnik me një vlerë të veçantë historike, poashtu Podujeva karakterizohet edhe me objekte të hershme fetare siç janë Xhamia e Brainës si dhe Kisha e vjetër e braktisur e Shën Arkangjell Mehilit në Rakinicë. Ajo e cila flet shumë për sakrificën e qytetarëve të Podujevës deri në arritjen e lirisë pasqyrohet më së miri në Kullën e Zahir Pajazitit në Rakinicë, Kompleksin Memorial Baza e Parë e UÇK-së në Lladoc dhe në Kompleksin Memorial në Penuhë.

Aktivitetet kulturore në Komunën e Podujevës

Komuna e Podujevës në vazhden e aktiviteteve kulturore dhe historike ka ditën e festës së saj publike, Dita e Çlirimit të Podujevës, e cila festohet më 19 qershor për çdo vit. Numri i aktiviteteve kulturore, sportive dhe historike që organizohen nga Komuna e Podujevës është i lartë dhe atë si në vijim: Dita e Pavarësisë, 7 Marsi Dita e mësuesit, Dita e Ambientit, 5 Maji - Dita e Dëshmorëve, Promovimi i librit, 1 Qershor-Dita e femijëve, Dita e Çlirimit, Ekspozitë, Dita e Diasporës Shala e Bajgorës, Panairi i Shoqatës së grave "ANTIKA", Festivali Teatri Ndryshe, Trashëgimia kulturore, Muaji i rinisë, 28 Nëntori Dita e flamurit, Takimet e kulturës "Kadri Kadriu", Kupa e qytetit, Turnir në futsall, Turnir për ditën e pavarësisë, Me bicikleta në pranverë, Turneu tradicional në Kërprimëh, Turne për nderë të Emin Simnicës, Turne në karate, Turne në volejball, Veteranët e Llapit dhe veteranët e Diasporës, Turne në futboll, Gjysmë maratona në atletikë, zgjedhja e sportistit të vitit e shumë të tjera.

Lista e aktiviteteve që organizon Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

Kulturë dhe rini

Aktiviteti	Muaji	Përshkrimi
Dita e Pavarësisë	shkurt	Koncert, turne në futboll
7 Marsi, Dita e mësuesit	mars	Zgjedhja e mësuesve më të mirë
Dita e Tokës	prill	Punë vullnetare në pastrim dhe gjelbërim
5 Maji, Dita e Dëshmorëve	maj	Promovim libri, turne në futboll
Promovim libri	maj	Promovim
1 Qershor, Dita e femijëve	qershor	Koncert, parakalim, ekspozite
Dita e Çlirimit	qershor	Koncert, shfaqje, turne në futboll
Ekspozitë	qershor	Ekspozite e artitfigurativ
Dita e Diasporës, Shala e Bajgorës	gusht	Koncert
Dita e Disaporës	gusht	Panair, shfaqje, sport
Panairi i Shoqatës së grave “ANTIKA”	gusht	Panair me punime artizanale
Festivali, Teatri Ndryshe	gusht	Shfaqje teatrore
Trashëgimi kulturore	gusht	Ekspozimi i eksponateve
Muaji i rinisë	shtator	Kamp, muzikë,teatër
28 Nëntori, Dita e Flamurit	nëntor	Koncert, sport
Takimet e kulturës “Kadri Kadriu”	dhjetor	Konkursi letrar, shfaqje

Tabela 4. Lista e aktiviteteve në kulturë dhe rini që organizon Komuna e Podujevës, burimi : Drejtoria për Kulturë, rini dhe Sport

Sport

Aktiviteti	Muaji	Pershkrimi
Kupa e qytetit, Turnir në futsall	janar	Turne për nder të Zahirit
Turnir për Ditën e Pavarësisë	shkurt	Turne në futboll
Me bicikleta në pranverë	mars	Gjysmëmaratona
Turne tradicional në Kërpimëh	maj	Turne në futboll
Turne për nder të Emin Simnicës	qershor	Turne në futboll
Turne në karate	qershor	Turne në karate
Turne në volejboll	qershor	Turne në volejboll
Veteranët e Llapit dhe veteranët e Diasporës	qershor	Turne në futboll
Turne në futboll	nëntor	Turne në futboll
Gjysmë Maratona në atletikë	nëntor	Gjysmë maratona në atletikë
Zgjedhja e sportistit të vitit	dhjetor	Zhgjedhja e sportistit të vitit

Tabela 4. Aktivitetet sportive të përvitshme të drejtorisë së kulturës Podujevë. Burimi: Drejtoria për Kulturë, rini dhe Sport

Komuna e Podujevës gjithashtu përkrahë financiarisht organizatat e Komunës që ndërmarrin iniciativa rinore, sportive dhe kulturore.

Turizmi, sot paraqitet si një nga industritë më të fuqishme në botë dhe si e tillë, ka një ndikim të madh në zhvillimin ekonomik e social të mjaftë vendeve, sidomos atyre në zhvillim ku shihet si një nga burimet më të rëndësishme të të ardhurave, të mundësive të punësimit, mbrojtjes së mjedisit si dhe të promovimit të shkëmbimeve ndërkulturore. Në Kosovë, sidomos gjatë viteve të fundit, janë bërë investime në rregullimin e infrastrukturës si një prej elementeve kyçe në promovimin dhe zhvillimin e ekoturizmit me theks të veçantë në zona të mbrojtura.

Ekoturizmi është lloj i turizmit që ka për qëllim udhëtimet në vendet e paprekura natyrore, në zonat e mbrojtura ose atraksionet tjera natyrore dhe që zakonisht përpiqet të minimizojë ndikimin e faktorit njeri në mjedis. Ai ka për objektiv edhe të promovojë edukimin mjedisor, të sigurojë fonde për ruajtjen e natyrës, të ndihmojë zhvillimin ekonomik, fuqizimin e komuniteteve lokale, si dhe të nxis respektin për kulturat e ndryshme.

Për Podujevën ekoturizmi është një dukuri e re, por në shumë vende të botës ky lloj turizmi është shtyllë e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik. Podujeva shquhet për vlera të rralla të trashëgimisë natyrore. Pozita gjeografike, relievi, klima, burimet ujore, peisazhet, bota e pasur bimore dhe shtazore janë parakushte ideale dhe potencial i lartë për zhvillimin e ekoturizmit. Podujeva ka mundësi të mira të zhvillimit të ekoturizmit malor, atij rekreativ-sportiv, veror, rural dhe atij edukativ.

Ekoturizmi malor dhe ecja në natyrë: Në zonat e thella malore të Podujevës ekzistojnë shumë shtigje malore të cilat përdorin blegtorët për bagëtitë e tyre dhe të cilat paraqesin mundësi reale për zhvillimin e ecjes në natyrë, shëtitjeve malore me biçikleta, por edhe të ekspeditave dhe kampingjeve. Ky lloj turizmi veçanërisht mund të zhvillohet, sidomos në zonat e fshatrave: Popovë Kaqandoll rreth 20 km, Murgull, Zhiti, Pakashticë, por gjithësesi edhe në pjesët përreth Liqenit të Batllavës, ku është një ambient jashtëzakonisht i përshtatshëm, por edhe i pastër për ecje.

Ekoturizmi veror dhe njëditor: Klima e përshtatshme, livadhet e pasura me llojlojshmërinë e bimëve si qershia, boronica, dredhëzat e malit, burimet e shumta ujore, peisazhet piktoreske janë parakushte të mira edhe për zhvillimin e turizmit veror dhe kampingut. Liqeni i Batllavës, Ujëvarat e Popovës, Muhazobit, zonat malore si Reqica, Murglla, Popova, Zhitia, Braina,

Metergoci, Drazhnja, Surdulli, Hertica, Kalatici, Rakinica, Turuqica, pjesët e maleve që lidhen me Mitrovicën (fshatrat Bradash, Dobratin, Revuqë, Kërpimeh, që të shtiejn për tek Shala e Bajgorës janë vetëm disa nga zonat që gjatë stinës së verës mund të jenë destinacion i përhershëm i shumë turistëve dhe adhuruesve të natyrës që dëshirojnë të kalojnë një ditë në natyrë.

Ekoturizmi rekreativ dhe sportiv: Në malet e Llapit gjenden shumë terrene të përshtatshme për zhvillimin e skitarisë (shtigje të shkurta, si psh. Pjesë të brigjeve në fshatin Herticë afër vijës kufitare me Serbinë). Kapaciteti i terreneve të skijimit të këtyre qendrave mund të pranojnë mijëra vizitorë gjatë sezonit të dimrit. Ndërsa, gjatë verës, në „malet e Llapit“ ka plotë maja të cilat janë shumë atraktive për zhvillimin e alpinizmit dhe bjeshkatarisë (si: rreth fshatrave Pollatë, Murgull, Reçicë, Tërnavicë, etj.).

Turizmi rural: Në shumë zona rurale të Llapit, e sidomos në ato malore, ende ruhen shumë zakone, tradita, lojëra, këngë, veshje e ushqime tradicionale. Këto pasuri të jashtëzakonshme kulturore janë një mundësi e mirë e zhvillimit të turizmit rural dhe promovimit të këtyre vlerave. Në veçanti, për këto vlera shquhen fshatrat malore që ofrojnë ushqime tradicionale dhe bioprodukte.

Turizmi edukativ dhe shkencor: Ekosistemet e paprekura malore, prania e llojeve të rralla bimore e shtazore, pasuritë nëntokësore të Llapit kanë potencial edhe për zhvillimin e aktiviteteve edukative e kërkimore me nxënës, studentë dhe shkencëtarë nga Kosova, por edhe për ekspedita të huaja hulumtuese. Përkundër këtyre vlerave të jashtëzakonshme dhe mundësive ideale për zhvillimin e ekoturizmit, mungesa e infrastrukturës, mungesa e investimeve, mungesa e planeve dhe projekteve konkrete ka penguar zhvillimin e kapaciteteve ekoturistike. Problem i veçantë është çësja që institucionet qeveritare dhe shoqëria kosovare ka ndaj shfrytëzimit të qëndrueshëm të këtij potenciali. Shfrytëzimi i pakontrolluar i resurseve natyrore, dëmtimi i ekosistemeve, gjuetia ilegale, zgjerimi i vendbanimeve janë kërcënim i vazhdueshëm për këto vlera. Me një promovim më profesional të zonave ekoturistike, me rritjen e investimeve dhe me përgatitjen e një strategjie kombëtare për zhvillimin e ekoturizmit do të mundësohej ruajtja e tyre.

<i>Pasuria natyrore</i>	Resurs	Fshati
<i>Lugina dhe qafa e Kaçandollit</i>	Ujor	Kaçandoll/ Dobratin
<i>“USHTON REKA”</i>	Ujor	Popovë
<i>Liqeni i Batllavës</i>	Ujor	Orllan/ Batllavë
<i>Burimi i ujit</i>	Ujor	Sallabajë
<i>Burimi i ujit</i>	Ujor	Shajkofe
<i>Trungu i Plepit</i>	Botanik	Murgull
<i>Trungu i Plepit</i>	Botanik	Bajçinë
<i>Burimi i Ujit</i>	Botanik	Dobratin
<i>Trungjet e dushkut në varreza</i>	Botanik	Llapashticë
<i>Trungu i Dushkut</i>	Botanik	Dyz
<i>Trungu i Plepit</i>	Botanik	Orllan
<i>Trungu i Plepit</i>	Botanik	Gërdoc
<i>Trungu i qarrit</i>	Botanik	Pollatë
<i>Trungu i qarrit</i>	Botanik	Dobratin

Tabela 5. Pasuritë natyrore të mbrojturja me ligj. Burimi : Agjensioni i Mbrojtjes së Mjedisit & Komuna e Podujevës PLVM

Resurset Ujore

Liqeni i Batllavës

Kompleksi i liqenit të Batllavës shquhet për bukuritë natyrore të gërshetuara nga liqeni, pyjet dhe peisazhi që e rrethon me sipërfaqe prej 220 km². Pyjet që e rrethojnë liqenin arrijnë lartësinë mbidetare, prej 800-1000 m. Liqeni i Batllavës paraqet një vend mjaft atraktiv për zhvillimin e ekoturizmit. Liqeni është i krijuar artificialisht në vitin 1959, për nevojat e Korporatës Energjetike të Kosovës për ftohjen e stabilimenteve ,më pastaj është përdorur për ujë të pijshëm ku edhe sot furnizohet një pjesë e madhe e qyteteve të Republikës së Kosovës.

Nga të dhënat e banorëve të Orllanit për katër vitet e fundit prej periudhës Maj – Shtator, vitet 2014 – 2018, numri i turistëve që kanë vizituar këtë pjesë sillet prej 130,000–150,000 turistë dhe vendet ku më së shumti vizitohen në rajonin e Orllanit janë: Liqeni dhe zonat për rreth , Kulla e Dëshmorëve, Quka e Brainës, Xhamia e Brainës, etj.¹⁴

¹⁴ ASK- Agjensioni i statistikave të Kosovës





Figura 2. Pamje Liqenii Batllavës (huazuar nga faqja "Komuniteti Orllan")

-  vegetacion gjetherënës
 -  vegetacion gjethembajtës
 -  zona e banuar
-  plazha
 -  vend pushimoret

Më poshtë kemi numrin e numrin e turistëve të cilët kanë vizituar Liqenin e Batllavës për periudhën 2015-2018 gjatë muajve të verës apo (Maj-Shtator).



Grafiku 1. Numri i turistëve që kanë vizituar Liqenin e Batllavës periudha 2015-2018 (Burimi: Bazuar në Bizneset lokale dhe banorë rezidentë të zonës)

Lumi Llap

Lumi Llap shtrihet në pjesën verilindore të Kosovës dhe burim të vetin e ka majën Pilatovica 1,703m. që njëherit paraqet pikën kryesore të ujëmbledhësit të Lumit Llap. Lumi Llap bashkohet me Sitnicën dhe gjatësia totale e Lumit Llap është 82,7 km.

Vrella e Revuqit

Vrella e Revuqit shtrihet në fshatin Revuçë dhe është një pikë ku buron uji i ftohtë dhe i pastër. Përveç vlerave turistike ky ujë mund të furnizoj rreth 8 fshatra të rrethinës. Në aspektin vizuel ka një pamje pitoreske dhe shumë atraktive.

Banja e Shakovicës

Shtrihet në fshatin Shakovicë dhe është e njohur për pasuritë me minerale. Si banjë me efekte shëruese deri më tani ka treguar efekt në trajtimin e shumë sëmundjeve, si: 1.Sëmundjet reumatike; 2.Problemet me unaza; 3.Hemoroidet (Problemet me zorrën e trashë); 4.Migrena; 5. Sëmundjet e lëkurës; 6.Stabilizon tensionin e gjakut; 7.Ndihmon në humbjen në peshë; 8. Prostatën; 9.Ndihmon në largimin e erës së keqe të këmbëve; 10.Sëmundjet reumatike artikulare dhe ekstra artikulare-degenerative, inflamatore, metabolike; 11.Sëmundjet neurologjike të Sistemit nervor: parezat dhe paralizat periferike ose qendrore, gjendjet pas insulteve cerebrovaskulare(sulmit në tru), neuralgjitë, neurozat, depresioni etj; 12.Gjendjet post traumatike (pas lëndimeve të kockave, muskujve, tetivave, ligamenteve, nervave); 13.Sëmundjet Kardiovaskulare; 14.Sëmundjet e traktit digjektiv-gastritet, duodeniti, ulcera e lukthit dhe duodenit,olecistitet kronike etj.; 15.Sëmundjet e sistemit urinar-inflamacionet kronike të traktit urinar, mikrolitiazat etj.; 16.Sëmundjet e lëkurës-ekzemat, psoriaza, akna vulgaris etj.; 17. Sëmundjet gjinekologjike-inflamacionet kronike të organeve gjentiale, steriliteti etj.

Kjo banjë ndodhet në magjistralen Prishtinë–Podujevë me një histori mjaft interesante. Ajo u zbulua si ilaç nga kali i një qytetari, të cilin e braktisi pronari, pasi mendonte se ai ishte sëmurë.



Figura 3. Banja e Shakovicës

<i>Viti</i>	<i>Periudha</i>	<i>Numrii turistëve/ vizita ditore</i>
2015	maj /shtator	160-220
2016	maj /shtator	220-240
2017	maj /shtator	200 – 220
2018	maj /shtator	250 – 300

Tabela 6. Paraqitja tabelore e numrit të turistëve që kanë vizituar Banjën e Shakovicës gjatë periudhës Maj – Shtator.
(Burimi: statistika të pronarëve të banjës)

Ujëvarat e Popovës

Në fshatin Popovë shtrihen disa mini ujëvara me pamje pitoreske. Përveç aspektit turistik këto ujëvara ofrojnë tinguj dhe pamje interesante. Në rrethinën e këtyre ujëvarave ka një vegjetacion të pasur i cili krijon kushte për turizëm dhe pushim. Ajri i pastër dhe freskia ndikon edhe në shërimin e sëmundjeve të ndryshme. Kjo pjesë e territorit të Podujevës mund të shfrytëzohet edhe për shtigje shumë të përshtatshme ecjesh. Ujëvara të ngjashme gjenden edhe në fshatin Muhazob.

Quka e Brainës

Shtrihet në fshatin Brainë dhe ka pamje mahnitëse me lartësi mbi 1,600 metra dhe supozohet se aty afër ka qenë edhe kalaja ku si dëshmi janë gurët e gdhendur në afërsi. Po ashtu në fshatin Brainë gjendet edhe burimi i ujit i quajtur “Kroi i Dashurisë”.

Bellosica

Bellosica shtrihet në pjesën veriore të Podujevës. Përvec pasurive floristike dhe faunistike ky vend ka rëndësi në aspektin historik sepse ka dëshmi të kohës ilire dhe nga ky fshat buron një ujë mineral i pasur me sulfur që ka efekt shërues të sëmundjet e ndryshme.

Musinca

Maja e Musincës njihet si maja më e lartë në Komunën e Podujevës dhe e cila gjendet në fshatin Murgull. Në këtë zonë ka llojëllorshmëri bimore ku dominojnë boronicat dhe qershiat, po ashtu ka vlera turistike sidomos në alpinizëm pasi që konsiderohet si zonë interesante për aktivitete të alpinistëve.

Produktet turistike në Podujevë

Për të përfituar nga përdorimi i burimeve turistike, duke pasur parasysh nevojat e tregjeve kryesore të synuara, zhvillimi i turizmit mund t'i shfrytëzojë në mënyrë të balancuar potencialet e tij dhe të përqendrohet në zhvillimin e këtyre produkteve turistike deri në vitin 2021:

- Turizmi i Kulturës me të gjitha llojet e tij (Historik/arkeologjik, Trashëgimia kulturore, etj.)
- Turizmi i Natyrës (Malor, Rural, Ekoturizmi, Agroturizmi, etj.)
- Turizmi shëndetësor (Turizmi i ujërave termale, Turizmi mjekësor)
- Turizmi i konferencave/biznesit

Një ofertë e tillë e produkteve turistike krijon mundësi për të zgjeruar grupin e vizitorëve të interesuar për lloje të ndryshme të udhëtimeve turistike dhe veprimtarive turistike, me synimin e rritjes së ndjeshme të veprimtarive turistike dhe të ardhurat nga sektori i turizmit në komunën e Podujevës. Nga ana tjetër, diversifikimi i llojeve të produkteve turistike mundëson përhapjen e veprimtarive turistike në të gjithë vendin, duke kontribuar drejtpërdrejt në reduktimin gradual të përqendrimit të tyre në disa zona të caktuara dhe gjatë gjithë vitit. Produktet turistike do të analizohen dhe vlerësohen në intervale të rregullta kohore për të matur peshën specifike të tyre,

duke krijuar mundësi për evidentimin e produkteve të reja apo edhe kombinimin ndërmjet produkteve të ndryshme.

Industria e turizmit

Rritja e aftësisë konkurruese në Komunën e Podujevës si destinacion turistik lidhet me standardet e cilësisë që ofrojnë të gjitha llojet e strukturave akomoduese. Zhvillimi në të ardhmen varet nga cilësia e lartë në ndërtimet e reja të strukturave dhe rritja e cilësisë në ato ekzistuese.

Akomodimi: Hotelet, bujtinat, shtëpi të përshtatura me qëllime të shfrytëzimit nga turistët, janë destinacion që tërheqin vizitorët. Zhvillimi i ofertës turistike duhet përmirësuar me objekte të reja hoteliere apo të ngjashme, bujtina të cilat ofrojnë kushte dhe infrastrukturë si lojëra për fëmijë, pushimore, pishina, etj. Akomodimi po ashtu mund të bëhet edhe në kampingje dhe dhoma apo apartamente.

Kampingjet duhet vendosur në atë mënyrë që të jenë më afër pikave turistike kurse akomodimi në dhoma familjare duhet të ofrojë kushte dhe çmime të arsyeshme dhe meny me ushqime tradicionale dhe bioprodukte.

Objektivat që lidhen me ofertën për akomodim:


- Shtyrja drejt përmirësimit të standardeve dhe cilësisë në strukturat akomoduese. Klasifikimi i strukturave akomoduese deri në vitin 2021, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;
- Rritja e numrit të shtretërve me 30% deri në vitin 2021;
- Regjistrimi i 100% të akomodimit familjar (dhoma, apartamente, shtëpi) deri në vitin 2021;
- Lehtësimet në ndërtimin e objekteve hoteliere, bujtinave dhe objekteve apo shtëpive të ngjashme në zonën e Liqenit të Batllavës, por edhe në zona tjera deri në vitin 2021;
- Dyfishimi i kapaciteteve në strukturat akomoduese në zonat rurale;
- Rritja tre herë e numrit të shesheve për kamping, që ofrojnë standarde ndërkombëtare;

SWOT Analiza

Në një analizë më të detajzuar të mjedisit të turizmit për komunën e Podujevës jemi mbështetur në analizën e pozicionit konkurrues, në kontekst të analizimit të Përparësive dhe Dobësive si faktorë të brendshëm, njëashtu dhe analizimit të Mundësive dhe Rreziqeve si faktorë të jashtëm.

Në realizimin e kësaj metode kemi arritur tek rezultatet relevante të cilat shërbejnë si input në hartimin e objektivave strategjike. Në procesin e realizimit të SWOT analizës nga grupa punuese është vepruar me objektivitet maksimal dhe analizim të detajuar të secilit rezultat të gjeneruar.

Rezultatet e ofruara nga zbatimi i SWOT analizës janë:



OBJEKTIVAT

Objektivat strategjike janë të ndërlidhura me zhvillimin e turizmit dhe të orientuara drejt përmbushjes së synimit kryesor të sektorit të turizmit. Objektivat kryesore kanë për qëllim zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe të sektorit të turizmit në nivel lokal, shtimin e investimeve dhe promovimin e vazhdueshëm të këtij sektori, me qëllim të përmirësimit të infrastrukturës së nevojshme për ofrim të produkteve cilësore, orientim të qartë dhe të lehtë në destinacione turistike.

Lëvizjet e vazhdueshme të popullësisë në nivel global, rajonal dhe lokal si dhe resurset me të cilat disponon Komuna e Podujevës bënë të mundur inicimin e zhvillimit të strategjisë së turizmit në mbështetje të zhvillimit të ekonomisë në nivel lokal.

Qëllimi që synohet nga zhvillimi i kësaj strategjie është përmirësimi i gjendjes ekonomike, rritja e punësimit në këtë degë të ekonomisë si dhe krijimi i një klime të favorshme për investime.

Në vazhden e investimeve të ndërmarrura nga Komuna e Podujevës në përmirësimin e sektorit të turizmit, komuna është e fokusuar në hartimin e kësaj strategjie nga e cila bënë të mundur zhvillimin e vizionit për sektorin e turizmit, duke ndërmarrur veprime konkrete në formimin e mekanizmave të nevojshëm në fazën e planifikimit, implementimit dhe kontrollit të vazhdueshëm.

Qytetarët, bizneset familjare, hotelëritë dhe shoqëria në tërësi me kalimin e kohës kanë ndryshuar bindjen sa i përket rëndësisë së zhvillimit të turizmit në funksion të përmirësimit të jetës së tyre në përgjithësi, andaj komuna synon që në përpjekje të zhvillimit të turizmit të krijojë ambient të përshtatshëm edhe për zhvillimin e sektorit privat në këtë komunë.

Në ditët e sotme turizmi paraqet një sektor mjaft të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik, ku përmes turizmit bëhet e mundur sjellja e investimeve të cilat joshin turistët duke i'u ofruar qasje në bukuritë natyrore, monumente historike, e të tjera. Rëndësia e zhvillimit të turizmit manifestohet me impakt direkt dhe indirekt në krijimin e të hyrave dhe gjenerim të punësimit nga operatorët ekonomik që janë të involvuar direkt ose indirekt, gjë e cila rezulton me përmirësimin e standardit jetësor dhe promovimin e vendit në arenën kombëtare dhe ndërkombëtare.

Objektivat e përgjithshme

Objektivat e përgjithshme të kësaj strategjie, synojnë të sigurojnë përgjigje adekuate për zhvillimin e sektorit të turizmit në nivel lokal, që janë:

1. Zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit në Podujevë për të kontribuar në zhvillimin ekonomik nëpërmjet shtimit të vizitave nga vizitorët vendor dhe të huaj, me fokus të veçantë në ngritjen e nivelit të punësimit në nivel lokal,
2. Rritja e investimeve në sektorin e turizmit dhe përmirësimi i infrastrukturës së nevojshme,
3. Promovimi i sektorit të turizmit në Podujevë në nivel më të gjerë, përmes metodave të ndryshme efektive.

Duke ditur faktin se këto objektiva të shfaqura nga Komuna e Podujevës nuk janë lehtësisht të përballueshme të realizohen edhe pas një angazhimi maksimal të të gjitha resurseve në dispozicion, atëherë Komuna do të angazhohet në kërkim të përkrahjeve të formave të ndryshme financiare, asistencës teknike në hartimin e projekteve konkrete edhe në nivelin qendror qeverisës dhe në organizata të ndryshme ndërkombëtare, me qëllim të jetësimit të vizionit të saj në afat kohor sa më të shkurtër të mundshëm.

Objektivat ekonomike

Sektorin e turizmit është një nga sektorët kyç të zhvillimit ekonomik të Komunës së Podujevës, jo vetëm për rolin e rëndësishëm që ka në kontributin e rritjes ekonomike lokale, por edhe për shkak të impaktit zinxhir që ka në sektorët e tjerë të ekonomisë. Impakti i këtij sektori lidhet me nevojat që ka për zhvillimin paralel të një sërë sektorësh të tjerë në mbështetje të turizmit. Duke marrë parasysh lidhjet direkte dhe indirekte të zhvillimit ekonomik me turizmin, objektivat kryesore ekonomike mund të grupohen si më poshtë:

1. Rritja e investimeve direkte dhe indirekte në sektorin e turizmit për 30% në 3 vitet e ardhshme në Komunën e Podujevës;
2. Rritja e punësimit në sektorin e turizmit për 25% në 3 vitet e ardhshme në nivel lokal;
3. Hapja e 1 (një) paraleleje në shkollat e mesme profesionale në fushën e turizmit në 3 vitet e ardhshme;

4. Rritja e hapësirave akomoduese të banimit për minimum 30% në 3 (tre) vitet e ardhshme përmes partneritetit publiko-privat, apo edhe përmes politikave lehtësuese të K. së Podujevës.

Objektivat cilësore

1. Krijimi i një imazhi pozitiv i Komunës së Podujevës si destinacion turistik në nivel lokal dhe ndërkombëtar;
2. Përgatitja e kualifikuar e stafit për ofrimin e shërbimeve turistike;
3. Përmirësimi i kushteve për orientim të vizitorëve në Komunën e Podujevës ;
4. Përmirësimi i qasjes në produkte dhe shërbime turistike përmes platformës së turizmit;

Fushat dhe drejtimet strategjike

Në përmbushjen e qëllimeve strategjike duhet vepruar në 5(pesë) fusha kryesore, me qëllim të përmirësimit të konkurrueshmërisë dhe jetësimit të objektivave strategjike. Fushat kryesore dhe drejtimet në të cilat duhet fokusuar këto politika janë:

1. Zhvillimi i produktit turistik/ Begatimi i ofertës turistike

- ✓ Produkti i turizmit rural dhe malor;
- ✓ Produkti i turizmit kulturor;
- ✓ Produkti i turizmit të natyrës;
- ✓ Produkti i turizmit shëndetësor;
- ✓ Produkti i turizmit të bizneseve/konferencave;

2. Përgatitja dhe edukimi i resurseve njerëzore në funksion të përmirësimit të cilësisë së produkteve dhe shërbimeve turistike

- ✓ Përgatitja e nevojshme strukturave të personelit për edukim dhe trajnim në fushën e turizmit;
- ✓ Trajnime specifike për komunitetin;
- ✓ Përmirësimi i standardit të jetesës në komunën Podujevës;

3. Promovimi i Podujevës si destinacion turistik gjatë tërë vitit;

- ✓ Marketingu dhe strategjitë e zhvillimit të turizmit;
- ✓ Promovimi i ofertës turistike (produkteve turistike)
- ✓ Involvimi i teknologjisë informative në zhvillimin e turizmit;

4. Ngritja e investimeve publike, private dhe partneriteti publiko-privat;

- ✓ Ngritja e nivelit të investimeve në sektorin e turizmit;
- ✓ Përmirësimi i indikatorëve dhe krijimi i kushteve të favorshme dhe lehtësirave të ndryshme atraktive për investime;
- ✓ Rritja e fokusit të nivelit lokal në sektorin e turizmit duke rritur investimet;

5. Hartimi i politikave dhe menaxhimi i tyre në sektorin e turizmit;

- ✓ Kompletimi i infrastrukturës ligjore dhe institucionale të nevojshme;

Fusha Kryesore: Zhvillimi i produktit turistik / Begatimi i ofertës turistike

Produkti i turizmit rural dhe malor

Faktor kryesor i zhvillimit të turizmit është zhvillimi i produktit. Nga pikëpamja gjeografike, produkti turistik është i përhapur më shumë në pjesën e Orllanit dhe në zonat malore të territorit të Komunës së Podujevës. Produkti turistik përfshinë trashëgiminë kulturore dhe natyrore të përhapur në gjithë zonat kryesore të Podujevës dhe ofertën kryesore ka liqenin e Batllavës.

Objektivat

- Zhvillimet e ardhshme duhet të përqëndrohen në ndërtimin e resorteve, kampingjeve (kategori e strukturave akomoduese) dhe rritjen e standardeve në shtëpitë private, duke synuar transformimin e tyre në struktura akomoduese.
- Thithja e investimeve të huaja direkte në sektorin e turizmit: në zonat dhe vendet urbane tashmë të zhvilluara, për përmirësimin e strukturave akomoduese ekzistuese, të cilat nuk janë të përshtatshme për tu përfshirë në ofertën turistike, për rivitalizimin e pronave shtetërore ekzistuese për qëllime të zhvillimit të turizmit.
- Të gjitha zhvillimet duhet të zbatojnë teknologji të reja, duke respektuar në mënyrë rigoroze standardet mjedisore dhe kriteret ekologjike.

Aktivitete

- Përmirësimi i cilësisë në të gjitha strukturat akomoduese duke përfshirë përmirësimin e ndërtesave dhe infrastrukturës përcjellëse dhe ofrimin e shërbimeve adekuate.

- Plotësimin e ofertës së akomodimit përmes përfshirjes së aktivitete të tjera ndihmëse, si sportive, rekreative, etj.
- Përmirësimi i cilësisë së akomodimit në shtëpitë private dhe respektimi i standardeve të përcaktuara në aktet nënligjore në fuqi;
- Përmirësimi i infrastrukturës turistike në zonën e liqenit të Batllavës dhe zonave tjera turistike;
- Ngritja e shtëpive të Bjeshkatarëve ;
- Zhvillimii atraksioneve të reja me qëllim tërheqjen e kërkesave të tregut rajonal dhe ndërkombëtar;
- Riorganizimi i infrastrukturës turistike në destinacionet turistike, që lidhet me plazhet te Liqeni i Batllavës, shëtitorët, sinjalistikën rrugore, sinjalistikën turistike, hapësirat e parkimit publik dhe transportin publik lokal;
- Përmirësimi i sistemit të informacionit turistik në destinacionin turistik;

Produkti i turizmit kulturor

Komuna e Podujevës është një destinacion mjaft tërheqës dhe mjaft i pasur kulturor. Investimet e nivelit lokal dhe qendror në objektet kulturore, fetare në qytet dhe fshatra kanë bërë që Podujeva të jetë pjesë e agjendës së shumë vizitorëve të brendshëm dhe të huaj.

Karakteristikë e turizmit kulturor është se ky lloj turizmi është i kërkuar gjatë tërë vitit dhe një fokus i veçantë duhet kushtuar atij në aspektin e investimeve duke e shndërruar këtë lloj turizmi në një pikë të fortë zhvillimore për komunën e Podujevës.

Kosova është duke u shëndërruar në një destinacion mjaft atraktiv për vizitorët e huaj, andaj Komuna e Podujevës duhet të jetë e fokusuar maksimalisht në krijimin e parakushteve për tërheqjen e vizitorëve. Rritja dhe zhvillimi i këtij produkti turistik është më lehtë i realizueshëm duke u nisur prej të kaluarës së lavdishme kulturore dhe historike që posedon qyteti i Podujevës.

Objektivat

- Zhvillimi dhe promovimi i veprimtarive kulturore me qëllim të tërheqjes së vizitorëve;
- Përgatitja e kalendarit vjetor me aktivitete kulturore;
- Rritja e peshës së turizmit kulturor në tërheqjen e vizitorëve në qytetin e Podujevës;

- Realizimi i investimeve në objekte hoteliere dhe restaurantesh të ngjashme me artitekturën dhe ushqimin e zonës.

Aktivitetet

- Zhvillimi i një plani për turizmin kulturor në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit;
- Krijimi dhe mirëmbajtja e zonave të veçanta për vizitorët;
- Shtytja e aktiviteteve kulturore për të pasuruar veprimtrinë kulturore-artistike dhe për të diversifikuar ofertën kulturore;
- Përmirësimi i vazhdueshëm i kuzhinës llapjane dhe promovimi i saj në nivel vendi dhe rajonal;
- Organizimi i takimeve direkte me përfaqësuesit e diasporës dhe ngritja e bashkëpunimit në fushën e kulturës;
- Hulumtimi i mënyrave për ringjalljen e artizanaleve të vjetëra të qytetit.

Produkti i turizmit të natyrës

Në destinacione të përzgjedhura me potenciale natyrore tërheqëse dhe fshatra tradicionale me një mënyrë jetese autentike, ekziston një gamë tërheqëse produktesh turistike me interes të veçantë. Ofertat për turizmin natyror janë të mirënjohura dhe të konsoliduara në tregjet kryesore të burimeve.

Objektivat

- Rritja e kontributit të turizmit të natyrës në të ardhurat dhe uljen e varfërisë në destinacione të ndryshme të vendit,
- Përgatitja e ofertave për nënproduktet e turizmit të natyrës për tregun. Përcaktimi i itinerareve rajonale të ecjes me biçikletë sipas mundësive, ecje në natyrë, gara për alpinizëm, oferta për lundrim në zonën e Liqenit, etj.,
- Përcaktimi i datave rajonale dhe ndërkufitare të udhëtimeve në këmbë (hiking). P.sh. Ecja për nder të z.Agim Kikaj,

- Rritja e standardeve të cilësisë në strukturat akomoduese dhe shërbimet në zonat rurale, malore dhe zonat e mbrojtura e parqet kombëtare dhe shenjzimi i zonave të ecjes me qëllim orientimin e turistëve.
- Ruajtja e mjedisit në ‘‘Parkun e Paqës’’ si pikë turistike në qytetin e Podujevës.

Aktivitete

- Hartimi i një studimi për vlerësimin e ndërtimit të qendrave dimërore komplekse (pistë skish, teleferik, shërbime tregtare, akomodim, veprimtari të tjera),
- Hartimi i një plani aktiviteteve për promovimin e turizmit alternativ,
- Krijimi i infrastrukturës turistike midis zonave malore, rurale dhe buzë liqenit të Batllavës,
- Evidentimi i objekteve të zbarazta turistike, duke respektuar elementët tradicional të ndërtimit dhe planin urban vendor të zhvillimit,
- Vlerësimi i aktiviteteve të përshtatshme për t’u zhvilluar dhe madhësisë së ofertës turistike në parqet natyrore dhe kombëtare dhe zonat e tjera të mbrojtura,
- Ngritja në atraksionet kryesore natyrore të qendrave moderne të vizitorëve me funksion edukativ dhe informues,
- Identifikimi i zonave të mundshme për zhvillimin e veprimtarive sportive si volejball, golf, etj.,
- Menaxhimi i sistemit të edukimit në vazhdimësi për sipërmarrësit në zonat rurale dhe malore,
- Përcaktimi i itinerareve të ecjes me biçikletë, hiking përfshirë sinjalistikën e itinerarit, vendin për të kaluar natën, sistemin e informacionit, nevojat për përmirësimin e infrastrukturës,
- Mbështetja e përfshirjes së ofertës nga Komuna për turizmin e ecjes ose me biçikletë në udhëzuesit ndërkombëtarë.

Produkti i turizmit shëndetësor

Produkti i turizmit shëndetësor synon të përmirësojë ofertën turistike Llapjane dhe të përmirësojë shpërndarjen gjeografike të saj, duke siguruar mundësi të reja të rritjes ekonomike, punësim dhe përdorim eficient të burimeve. Aktualisht ky lloj produkti është adresuar në mënyrë sporadike edhe pse rajoni i Llapit përfshinë hapësirën më të madhe me territor në

Kosovë, posedon vende ku mund të ndihmojë në trajtimin dhe menaxhimin e shumë sëmundjeve si ato respiratore, kardiovaskulare, të lëkurës, reumatike, etj.

Objektiva

- Podujeva vend ideal në tregun rajonal dhe ndërkombëtar për produktin e turizmit shëndetësor,
- Zhvillimi i ofertës së turizmit shëndetësor për segmente të ndryshme të tregut, të cilët janë përdoruesit e shërbimeve shëndetësore, mjekësore, të mirëqenies dhe rekreacionit,
- Përmirësimi dhe ndërtimi i qendrave mjekësore, rritja e standardit akomodues dhe zhvillimin e aktiviteteve zbavitëse,
- Tërheqja e investimeve për zhvillimin e strukturave të reja akomoduese në zonat e pasura me ujëra termale si Shakovica, Bellosica, me qëllim plotësimin e ofertës së turizmit shëndetësor,
- Zhvillimii objekteve të reja të turizmit shëndetësor duke ruajtur strukturën dhe natyrën,
- Studimi i tokave që plotësojnë standardet për kultivimin e bimëve me aftësi shëruese, si: shafranit organik si bimë me vlera të veçanta shëndetësore, por edhe bimëve tjera medicinale.

Aktivitete

- Realizimi i një studimi fizibiliteti për zhvillimin e turizmit shëndetësor në disa vendburime termale dhe zona malore në komunën e Podujevës,
- Hartimi i një plani veprimi për zhvillimin e turizmit shëndetësor në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe institucionet tjera relevante,
- Bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar me qëllim të zhvillimit, promovimit dhe ngritjes së kapaciteteve të turizmit shëndetësor,
- Shqyrtimi i mundësive për rritjen e hapësirave të tokave për mbjellëtë bimëve me aftësi shëruese, si: shafran, kamomilë, aronia dhe bimëve tjera me vlera medicinale,
- Ngritja e një shoqate profesionale komunale për turizmin shëndetësor, me fokus në testimin e tregut, ofrimin e informacionit, edukimin dhe bashkëpunimin me shoqatat e komunave tjera si edhe organizata tjera ndërkombetare.

Fusha Kryesore: Përgatitja dhe edukimi i resurseve njerëzore në funksion të përmirësimit të cilësisë së produkteve dhe shërbimeve turistike

Përgatitja e nevojshme e strukturave të personelit për edukim dhe trajnim në fushën e turizmit

Roli dhe rëndësia e turizmit për një vend në aspektin e zhvillimit ekonomik është tejet e madhe, por ky funksion mund të jetësohet vetëm nëse kemi një kuadër të përgatitur dhe profesional. Nevoja për cilësi të burimeve njerëzore në sektorin e turizmit është baza për të pasur një ofertë në nivelin e duhur dhe konkurruese në tregun e turizmit. Dinamika e ndryshimeve në tregje dhe zhvillimi i teknologjive të reja bëjnë të domosdoshme kërkesën për burime njerëzore të kualifikuara në mënyrë që rezultatet të jenë të mundëshme në fushën e turizmit.

Objektivat

- Profilizimi i shkollave të mesme me nevojat e tregut dhe ngritja e një sistemi të qëndrueshëm me bazë plotësimin e kërkesave nga sektori i turizmit,
- Sigurimi i burimeve njerëzore me kualifikime të mjaftueshme për sektorin e turizmit,
- Promovimi dhe ofrimi i mundësive për banorët lokal që të angazhohen dhe të participojnë në zhvillimin e turizmit,

Përgatitja dhe aftësimi profesional janë të ndërlidhura ngushtëme pasurimin e ofertës së produkteve dhe shërbimeve cilësore. Sistemi i edukimit të burimeve njerëzore në funksion të turizmit duhet të jetë i rregulluar si një përgjegjësi e përbashkët e akterëve relevant.

Aktivitetet:

- Drejtoria Komunale e Arsimit në Podujevë në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë të hartoj kurrrikula të veçanta në shkollat profesionale të cilat i përgjigjen kërkesave të sektorit të turizmit,
- Ngritja e vetëdijes së bizneseve për këshillim në nivel lokal dhe qendror,
- Identifikimi periodik i nevojave për trajnim të personelit.

Trajnime specifike për personelin dhe komunitetin

Një nga parakushtet bazë për ngritjen e cilësisë dhe rritjen e bizneseve është orientimi i arsimit profesional drejt nevojave të tregut, me qëllim të krijimit të fuqisë punëtore të kualifikuar në të gjitha sferat ekonomike të një vendi. Mirëpo, duke ditur që konkurrenca në treg dita ditës vjen e rritet ky edukim duhet të jetë me standarde sa më të larta.

Aktivitetet

- Kurrikulat e arsimit profesional të hartohen në kordinim të plotë në mes institucioneve relevante në nivelin lokal dhe qendror dhe me përfaqësuesit e bizneseve,
- Identifikimi i trajnimeve profesionale që ofrohen në nivel vendor dhe ndërkombëtar.

Përmirësimi i standardit të jetesës në komunën Podujevës

Qëllimi kryesor i secilit vend është përmirësimi i cilësisë së jetës, andaj qëllimi kryesor i këtij dokumenti është i ndërlidhur me ofrimin e kushteve sa më të mira të jetesës për komunitetin.

Çdo destinacion turistik është e mundur të zhvillohet dhe të jetë atraktiv për vizitorët e tjerë vetëm nëse në atë proces është i involvuar edhe komuniteti, prandaj përfshirja e tij është e pa-tjetërsueshme.

Aktivitetet

- Krijimi i programeve të veçanta trajnuese për banorët e zonave me karakter turizmi, duke mundësuar punësim më të lehtë në aktivitete që gjenerojnë të ardhura,
- Shfrytëzimi i turizmit si shtytës për zhvillimin e sektorëve tjerë të ekonomisë duke stimuluar prodhimin dhe konsumin,
- Shfrytëzimi i mekanizmave të nevojshëm institucional për mirëmbajtjen e pasurive të trashëgimisë kulturore.

Fusha Kryesore: Promovimi i Podujevës si destinacion turistik gjatë tërë vitit

Zhvillimi i një fushate të veçantë të Marketingut

Rëndësia e aktiviteteve që lidhen me marketingun është tejet e madhe pasi që ato paraqesin një pjesë të rëndësishme që Komuna e Podujevës të njihet si destinacion turistik. Aktivitetet e marketingut janë bazë në promovimin e ofertës turistike në tregjet e synuara. Kohët e fundit, në botën moderne dhe në çdo vend, çdo gjë thuajse zhvillohet përmes marketingut, andaj edhe në këtë fushë gjithsesi se duhet shqyrtuar mundësia e zhvillimit të një fushate marketingu dhe atë në kontinuitet të pandërprerë, në mënyrë që të bëhet promovim i pandërprerë i turizmit në K.të Podujevës.

Objektivat

- Nëpërmjet promovimit të rritet kureshtja e vizitorve për ta vizituar Komunën e Podujevës;
- Ngritja e gamës së produkteve turistike dhe promovimi i tyre;
- Shtimi i vëllimit të shitjeve të produkteve turistike;
- Rritja e imixhit të produkteve turistike;

Pra që ky destinacion turistik të jetë në agjendat e vizitorëve në vazhdimësi dhe për ta bërë këtë vend atraktiv që të vizitohet në të gjitha stinët e vitit duhet të zbatohen aktivitete të marketingut në vazhdimësi.

Aktivitetet

- Të hartohet një dokument i veçantë i Strategjisë së Marketingut për Turizmin në Komunën e Podujevës,
- Hulumtimi i saktë i numrit të vizitorëve në Komunën e Podujevës gjatë një viti.

Promovimi i ofertës-produkteve turistike

Promovimi paraqet aktivitetin bazik në lansimin e produkteve turistike, andaj duhet analizuar në mënyrë të detajuar secilin hap që ndërmerret në kuadër të promovimit dhe që të përmbushen objektivat e synuara.

Aktivitetet

- Hapja e zyrave turistike në hyrje të qytetit,
- Themelimi i shoqatës së turizmit në nivel lokal,
- Pjesëmarrja në panaire dhe ekspozita të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, nga grupe të caktuara përgjegjëse për sektorin e turizmit në Komunën e Podujevës,
- Krijimi i një ekipe profesionale që të merret me zbatimin profesional të marketingut inovativ,
- Krijimi dhe lansimi i spoteve të ndryshme publicitare.

Involvimi i teknologjisë informative në zhvillimin e turizmit

Evoluimi teknologjik në kohët e fundit ka bërë ndryshime radikale sa i përket njohjes me destinacione dhe produkte turistike nga ana e vizitorëve. Sot falë zhvillimit të teknologjisë të gjitha proceset e zhvillimit të turizmit kanë ndryshuar dhe janë lehtësuar në masë të madhe. Roli i teknologjisë informative ka rritur efektivitetin e kompanive turistike në procesin e planifikimit dhe realizimit të shërbimit. Në ditët e sotme turistët nga mbarë bota para se të nisen në një vizitë turistike, ata e dijnë me saktësi se ku do të shkojnë cilat janë kushtet e banimit, çmimet, llojllojshmëria e produkteve dhe aktivitetet argëtuese, falë aplikacioneve dhe platformave të ndryshme të zhvilluara enkas për këto qëllime.

Fusha Kryesore: Ngritja e investimeve publike, private dhe partneriteti publiko-privat

Deri në ditët e sotme niveli i investimeve në sektorin e turizmit në Komunën e Podujevës edhe në Kosovë në tërësi nuk ka pasur trajtim merit. Megjithatë, në kohët e fundit shihet një dritë shprese në fund të tunelit edhe për këtë sektor. Zbatimi i strategjive të turizmit në funksion të zhvillimit ekonomik nënkupton realizimin e projekteve konkrete në interes të banorëve të zonave turistike dhe qytetarëve në përgjithësi duke kontribuar në përmirësimin e standardit të jetës.

Objektivat

- Krijimi i lehtësirave për investitorët në sektorin e turizmit,

- Ofrimi i normave të favorshme të interesit për investitorët në sektorin e turizmit,
- Ngritja e nivelit të bashkëpunimit të bizneseve me komunitetin,
- Përputhja e strategjisë së turizmit me strategjitë e tjera zhvillimore në nivel lokal dhe nacional,
- Përqëndrim më i madh i investimeve publike në zonat me potencial të zhvillimit në sektorin e turizmit.

Ngritja e nivelit të investimeve në sektorin e turizmit

Qëllimi i zbatimit të strategjisë është krijimi i një mirëqenie ekonomike më të mirë për qytetarët duke ngritur standardin e jetës, por ky standard nuk mund të realizohet pa investime konkrete. Problemet më të mëdha në realizimin e investimeve konkrete janë barrierat me të cilat ballafaqohen dhe të cilat duhet eliminuar.

Aktivitetet

- Ofrimi në shfrytëzim i hapësirave të nevojshme për ndërtimin e objekteve hoteliere të standardit të lartë,
- Përmirësimi i kushteve në hapsirat ekzistuese banuese,
- Ndërtimii shtegut për kombësorë prej fillimit të Liqenit të Batllavës deri në Orllan nëpër pyll,
- Hapja e tualeteve publike në pikat turistike,
- Vendosja e ndriçimit prej buzë Liqenit të Batllavës deri në Orllan,
- Analizmi dhe shqyrtimi për të mundësuar lansimin e një linje të autobusëve apo transportit, Podujevë-Prishtinë-Aeroport me itinerare të ndryshme.

Përmirësimi i indikatorëve dhe krijimi i kushteve të favorshme për investime

Investimet paraqesin një aktivitet me risk, prandaj institucionet kompetente duhet medoemos të krijojnë një klimë të favorshme investive për investitorët. Ky veprim nuk është i thjeshtë për t'u jetësuar pasi që kërkon përfshirjen e një varg akterësh relevant, duke filluar nga ligjvënësit deri te ekzekutivi. Andaj për të përmirësuar këto kushte duhet që të hartohen dhe zbatohen të gjitha ligjet dhe rregulloret nga niveli qendror dhe lokal.

Aktivitetet

- Mbajtja e konferencave të ndryshme për njoftuar investitorët potencial lidhur me mundësitë e turizmit në komunën e Podujevës,
- Ofrimi i skemave të përkrahjes financiare për investitorët,
- Definimi i qartë i çështjeve pronësore lidhur me investimet ku do të realizohen.

Rritja e fokusit të nivelit lokal në sektorin e turizmit duke rritur investimet

Investimet konkrete nga niveli lokal në zonat me karakter turizmi ndihmojnë tejmasë në realizimin e projekteve konkrete edhe nga sektori privat dhe partneriteti publiko-privat. Qëllimi i këtij dokumenti strategjik është krijimi i kushteve të nevojshme për të ngritur nivelin e bashkëpunimit mes sektorit publik dhe atij privat dhe në këtë mënyrë për të jetësuar synimet e strategjisë.

Aktivitetet

- Përmirësimi i rrjetit infrastrukturor në të gjitha zonat turistike dhe ofrimi i qasjes në transport publik,
- Përmirësimi i nivelit të shërbimeve shëndetsore në zona me karakter turizmi,
- Ndërmarrja e aktiviteteve konkrete për të ruajtur zonat me karakter kulturor, mbrojtja dhe konzervimi i monumenteve kulturore.

Fusha Kryesore: Hartimi i politikave dhe menaxhimi i tyre në sektorin e turizmit

Nivelet qeverisëse kompetente duhet të fokusohen në hartimin e politikave që nxisin zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Në këtë drejtim politikat duhet të hartohen në koordinim të plotë me rregullativat ekzistuese ligjore, interesat e komunitetit dhe investitorëve aktual dhe atyre potencial.

Objektivat

- Zhvillimi dhe avancimi i ligjeve dhe politikave zhvillimore për të ndërtuar turizmin si një nga sektorët më të qëndrueshëm,

- Rritja e nivelit të komunikimit mes sektorëve në nivel lokal dhe qendror, në përpjekje për ta intensifikuar zhvillimin e turizmit,
- Krijimi i qasjes gjithë përfshirëse në menaxhimin dhe zhvillimin e turizmit duke krijuar ambientin e nevojshëm të veprimit për të gjitha palët.

Kompletimi i infrastrukturës ligjore dhe institucionale të nevojshme

Strategjia si dokument synon të ofroj një qasje të qëndrueshme përballë sfidave, duke reflektuar mbi kërkesat të cilat dalin nga palët e involvuara në këtë qështje. Nëpërmjet kësaj strategjie synohet që të evitohen dhe evidentohen të gjitha qështjet që kontribuojnë në zhvillimin e sektorit të turizmit në Komunën e Podujevës.

Aktivitetet

- Krijimi i politikave të planifikimit hapësinor që orientojnë zhvillimin e turizmit, kjo qështje realizohet në mes koordinimit të plotë me nivelin komunal dhe Ministrinë e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor.

ANEKSET

PLANI I VEPRIMIT 2019-2021

DREJTIMI STRATEGJIK	VEPRIMET E IDENTIFIKUARA	PËRÇEGJESIT E IMPLEMENTIMIT	PLANII VEPRIMIT GJATË VITEVE	
			2019	2021
	FUSHA KRYESORE: BEGATIMII OFERTËS TURISTIKE			
	AKTIVITETET			
	Përmirësimi i sistemit të informimit në aspektin turistik	3	DKRS	1 2 3 4 5 6 7 8 9 0 1 1 1 2 1 2 1 1 1 1 1 2
	Përmirësimi i sistemit të sigurisë	3	PK/KK	
	Krijimi dhe mirëmbajtja e zonave të veçanta për vizitorët	2	DPZHE	
PRODUKTI KULTUROR	Zhvillimi i një plani për turizmin kulturorë në bashkëpunim me MKRS	2	MKRS/D KRS	
	Organizimi i takimeve direkte me përfaqësuesit e diasporës dhe ngrija e bashkëpunimit në fushën e kulturës	2	DKRS	
	Hulumtimi i mënyrave për rrigalljen e artizanaleve të vjetëra të qytetit	1	DKRS	
	Përmirësimi i vazhdueshmërisë së kuzhinës ilopjanë dhe promovimi i saj	1	OE/ Familjet	
	Perfshirja e të gjitha fshatrave të Podujevës në ofertën turistike dhe evidencimi i potencialëve të tyre në fushat strategjike si: ekologjizimi, turizmi malor, shëndetësor, kulturor, sportiv etj.	3	DPZHE	
EKOTURIZIMI	Krijimi i kushteve infrastrukturore si: rregullimi i shtrigëve për këmbësorë në fshatrat Lupp-Majac-Popovë, pastaj Polllatë-Breçë-Tërnavice-Reçë, pastaj rreth Liqenit të Badlavës dmth fshatrave përreth, pastaj shtrigë për biçikleta, dhe gërritësi edhe socializimin e zonave turistike (shtrigëve të esjes dhe biçikletave) gjithmonë duke ruajtur natyrën.	3	DPZHE/ DPUMMI	
	Vendosja e siporave për mbeturina, pishmorange dhe tabela orientuese për secilin lokalitet me interes të veçantë turistik	3	DPUMM	
	Ndërtimi i një piste skijimi të vogël në fshatrat Hericë	2	DPZHE	
	Shqyrtimi dhe ndërtimi të një objekti shëndetësor, në pjesën e fshatrave Bradash dhe Dobrain, tek pjesa e quajtur "Te Pishat apo Kershë i Bardhe", për qëllime shëndetësore-mjekësore për personat me sëmundje të muskullit dhe kancerit, meqë kjo pjesë ka të mbijellura shumë Drunjtë Prie dhe poashtu edhe drunjtë dhe bimë tjera me veti shëruese, por edhe lartësi të konsiderueshme mbidetare	1	DPZHE	

		Zgjerimi i hapësirave të ndryshme sidomos në zonat e identifikuar me vlerë të veçantë turistike	3	DSHP	
		Rregullimi i shërgat për biçikletë nga fshati Baraninë deri në fshatin Orllan në distancë 4-5 km.	2	DPUMM	
		Ndërtimi i hapësirave sportive në fshatin Orllan (Fusha e tennisit, golfit, vëljebollit)	2	DPZHE	
		Ngritja e një qendre edukative- informuese për turistët në Orllan.	2	DPZHE	
		Përmirësimi i infrastrukurës së përgjithshme : ndriçimi i rrugëve, sinjalistika , e sidomos akomodimi	2	DPZHE	
		Vendosja e hartave orientuese dhe informuese për ofertën turistike duke prezantuar pasuritë floristike dhe faunistike, asetet kulturore, vlerat shëndetësore, ushqimi tradicional në fshatrat e Produtjeve etj.	3	DPZHE/DPUMM/DSHMS	
		Rregullimi i shërgat për ecje në distancë prej 24km nga fshati Pakashicë-Sylevicë-Zhiti-Breçë-Ternavice-Murgjell në arrihtë të Maja e Musincës	3	DPZHE	
		Rregullimi i shtrigjeve për ecje nga fshati Luppë- Popovë- Segash.	3	DPZHE	
		Përmirësimi i sigurisë Vendosja e mburojave në zona ku rrezikohen turistët si psh: lartësitë, lumenjtë etj.	2	DPUMM/DSHP	
		Ngritja e 5 shtrigjeve malore në pesë zona rurale si: Reqicë, Murgulli, Popovë, Bellosicë dhe Çenogë	1	DPZHE/DPUMM	
		Caktimi i shtrigjeve për ecje dhe rregullimi i tyre me sinjalistike për orientimin e turistëve.	2	DSHP	
		Studimi i fizibilitetit për zhvillimin e turizmit shëndetësor - bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë ndërtimin e një Spitali Pulmonologjik.	2	DPZHE/DSHMS	
		Identifikimi i zonave rurale dhe malore të pasura me bimë mjekësore.	1	DBPZHR	
		Promovimi i ujërave termale me veti të shumta shëruese siç janë: Banja e Shakovicës, Ujërat termale në Bellosicë etj.	2	DPZHE/DSHMS	
		Listimi i pikave me larësi mbudatëre ku përveç vlerave ekoturistike mundësohet edhe trajtimi i sëmundjeve të gjakut.	2	DBPZHR	
		Mbajtja e tokave me bimë mjekësore siç janë : shufrani, kamomila, aronia, mentia etj.	2	DBPZHR/DSHMS	
		Të përpilohet udhëzues për të gjitha vlerat medicinale që kanë fruit malorë, bimë mjekësore që gjenden në zonat malore të Komunës së Podujevës.	2	DBPZHR/DSHMS	
		Krijimi i një shoqate që përbehet nga biologë, gjeograf, mjekë për testimin e bioprodukteve që kanë vlerë shëndetësore.	2	DPZHE	
		Hartimi i një studimi për zhvillimin e ofertës së turizmit ndërkufitar me fokus të veçantë në Merdare.	2	DPZHE	
		Caktimi i një date brenda vitit ku të mbahet panair ku promovohen vlerat turistike, kulturore, fetare etj, ku ftohen edhe bizneset vendore, rajonale dhe ndërkombëtare.	3	DPZHE/DKRS	

TURIZMI MALOR DHE RURAL

TURIZMI SHËNDETSOR

TURIZMI NDËRKUFITAR

FUSHA KRYESORE: PËRGATITJA DHE EDUKIMI I RESURSEVE NJERËZORE NË FUNKSION TË PËRMIRËSIMIT TË CILËSISË

AKTIVITETET					
PËRGADITJA E NEVOJSHME E STRUKTURAVE TË PERSONELIT PËR EDUKIM DHE TRAJNIM NË FUSHËN E TURIZMIT	DKA në Podujë e së bashku me MASHT të hartojë kurrikula të veçanta në shkollat profesionale të citat i përgjigjen kërkesave të sektori të turizmit.	3	DK A MA SHT		
	Ngritja e vetedijës së biznesve për këshillim	2	DPZ HE		
TRAJNIME SPECIFIKE PËR PERSONELIN DHE KOMUNITETIN	Kurrikulat e asistimi profesional të hartohen në koordinim të plotë mes institucioneve relevante në nivel lokal dhe qendror dhe me përfaqësuesit e bizneseve.	3	MA SHT DK A BIZ NES		
	Identifikimi i trajnimeve profesionale që ofrohen në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.	1	BIZ ET NES ET		
PËRMIRËSIMI STANDARDIT TË JETËS	Krijimi i programeve të veçanta trajnuese për banorët e zonave me karakter turizmi.	2	DPZ HE		
	Shfrytëzimi i mekanizmeve institucionale për mirëmbajtjen e pasurive të trashëgimisë kulturore.	2	DK RS		
FUSHA KRYESORE: PROMOVIMI I PODOJËVËS SI DESTINACION TURISTIK GJATË TËRË VITIT					
AKTIVITETET					
MARKETINGU DHE STRATEGJIA E ZHVILLIMIT TË TURIZMIT	Te hartohet një dokument i veçantë i strategjisë së Marketingut për turizmin në komunën e Podujëvës.	3	DPZ HE DK		
	Hulumtimi i saktë i numrit të vizitorëve në komunën e Podujëvës gjatë një viti	3	DPZ HE		
PROMOVIMI OFERTËS TURISTIKE	Themelimi i shoqatës së turizmit në nivel lokal.	3	DK RS/ SH. C		
	Hapja e zyrave informuese turistike në hyrje të qytetit.	3	DK/ DZ HE		
	Pjesëmarrja në panairë dhe ekspozita të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare.	1	OE/ DPZ HE		
	Krijimi i një ekipi profesional që merret me zbatimin profesional të marketingut inovativ.	2	DPZ HE		
	Krijimi dhe lansimi i spotëve publicitare.	3	DPZ HE/ OE		
INVOLVIMI TIK NË ZHVILLIMIN E TURIZMIT	Ofrimi i qasjes së vazhdueshme në internet në të gjitha zonat turistike	3	MI/ DPZ HE		
FUSHA KRYESORE: NGRITJA E INVESTIMEVE PUBLIKE, PRIVATE DHE PARTNERITETI PUBLIKO-PRIVAT					
AKTIVITETET					
Ngritja e niveleve të investimeve në	Ndërtimi i shërgjës për këmbaror prej fillimit të Luqentit të Baillavës deri në Orilan nëpër pyll.	3	DPZ HE		

sektorin e turizmit PËRMIRËSIMI I NDIKATORËVE DHE KRIJIMI I KUSHTJEVE TË FAVORSHME PËR INVESTITIME	Hapja e tualetëve publike në pikat turistike	3	DPZ HE	
	Vendosja e ndriçimit prej buze Ligëntit të Barllavës den në Orlilan	3	DPZ HE	
	Lansimi i linjës së autobusëve Podujevë-Prishtinë-Aeroport	2	DPZ HE	
	Ofrimi i hapësirave të nevojshme për ndërtimin e hoteleve.	3	DCJ PK/ MA PH	
	Përmirësimi i kushteve në hapësirat banuese.	3	OE/ Fam iljet	
	Përmirësimi i rrethit infrastrukturor në të gjitha zonat turistike dhe ofrimi i qasjes në transport publik.	3	DPZ HE/ DK	
	Përmirësimi i nivelit të shërbimeve shëndetësore në zonat me karakter turizmi.	3	DS HM S	
	Ndërmarrja e aktiviteteve konkrete për të ruajtur zonat me karakter kulturor, mbrojtja dhe konservimi i monumenteve kulturore.	2	DK RS	
	FUSHA KRYESORE: HARTIMI I POLITIKAVE DHE MENAXHIMI I TYRE NË SEKTORIN E TURIZMIT			
	AKTIVITETET			
Kompletimi i infrastrukturës ligjore dhe institucionale të nevojshme	Hartimi i politikave të planifikimit hapësror që orientojnë zhvillimin e turizmit	2	MM PH DPZ HE	

TABELA ME FSHATRA E KOMUNËS SË PODUJEVËS GJITHSEJ 78 FSHATRA

1	Bajçinë	40	Letanc
2	Balloc	41	Livadicë
3	Barainë	42	Llugë
4	Batllavë	43	Lluzhan
5	Bellopojë	44	Majac
6	Bllatë	45	Muhazob
7	Bradash	46	Metergoc
8	Brainë	47	Merdar
9	Brecë	48	Metohi
10	Bërvenik	49	Miroc
11	Buricë	50	Murgull
12	Dobërdol	51	Obranqë
13	Dobratin	52	Orllan
14	Dumnicë e Poshtme	53	Pollatë
15	Llapashticë e Poshtme	54	Penuh
16	Pakashticë e Poshtme	55	Peran
17	Lupç i Poshtëm	56	Podujevë
18	Siboc i Poshtëm	57	Popovë
19	Dumosh	58	Potok
20	Dyz	59	Përpellac
21	Dvorishtë	60	Radujevë
22	Gllamnik	61	Rakinicë
23	Godishnjak	62	Reçicë
24	Dumnicë e Epërme	63	Rep
25	Llapashticë e Epërme	64	Revuç
26	Pakashticë e Epërme	65	Shajkoc
27	Lupç i Epërm	66	Shakovicë
28	Siboc i Epërm	67	Sylevicë
29	Gërdoc	68	Sllatinë
30	Halabak	69	Shtedim
31	Hërticë	70	Surdull
32	Kaçybeg	71	Surkish
33	Kalaticë	72	Sveçël
34	Šallabajë	73	Tërnav
35	Kunushhec	74	Tërnavicë
36	Kërpimëh	75	Turuçicë
37	Kushevicë	76	Velikarekë
38	Lladoc	77	Zakut
39	Llaushë	78	Zhiti

**LISTA E SHOQATAVE DHE PERSONAVE QË KANË KONTRIBUAR ME
INFORMATAT E TYRE NË HARTIMIN E STRATEGJISË SË TURIZMIT PËR
KOMUNËN E PODUJEVËS**

1. Shoqata e Alpinistëve dhe Bjeshkatarisë "Llapi"
2. Shoqata e Historianëve të Podujevës
3. Latif Mehmeti - Koordinator i fshatrave të Komunës së Podujevës
4. Patriot Rudari - profesor i Gjeografisë – asambleist KK Podujevë
5. Fatmir Rudari - profesor i Historisë – asambleist KK Podujevë
6. Zijadin Zeqiri - drejtor SHFMU "Zahir Pajaziti" Orllan
7. Ajet Ajeti - drejtor SHFMU" Kongresi i Manastirit " Gllamnik
8. Ahmet Gashi - drejtor SHFMU " Drita" Majac
9. Sabri Dema - drejtor SHFMU " Shefki Latifi " Pollatë
10. Hamit Beqiri - drejtor SHFMU " Jahë Hasani " Bërvenik
11. Muhamet Murati - profesor i Historisë
12. Afrim Azemi - profesor i Historisë
13. Nuhi Selimi - Kryetar i fshatit Orllan
14. Afrim Nura - mësimdhënës Brainë
15. Fahri Hoxha - profesor i Gj. Angleze – banor i Orllanit
16. Rexhep Zeka - banor i Orllanit
17. Pronarët e restoraneve në Orllan
18. Kryetarët e disa fshatrave
19. Bujar Azemi - bashkëpronar i "Banjës së Shakovicës"
20. Kushtrim Ajeti - profesor , banor i fshatit Sallabajë
21. Sylejman Sinani - banor i fshatit Popovë
22. Vedie Sejdiu - kryetare e Shoqatës "Antika"
23. Muhamet Rushiti - banor i fshatit Gllamnik

Po ashtu në hartimin e strategjisë kanë kontribuar edhe shumë banorë të fshatrave dhe qytetit të cilët kanë dashur të mbesin anonim.